



Republika e Kosovës  
Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / StateProsecutor  
Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit / Kancelarija Glavnog Državnog Tužioca/ Office of the Chief  
State Prosecutor

# Raporti gjashtëmuajor i punës së Prokurorit të Shtetit janar-qershori 2023

# Raporti i punës së Prokurorit të Shtetit

gjashtëmujori i parë 2023

© Prokurori i Shtetit 2023

Publikuar nga Prokurori i Shtetit. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përmbajtja e këtij materiali nuk mund të rishtypet, shumëzohet ose përcjellët në çfarëdo forme tjetër elektronike, mekanike, të fotokopjohet ose regjistrohet pa miratimin me shkrim të Prokurorit të Shtetit (PSH).

## Tabela e përbajtjes

Shkurtesat .....	5
Përbledhje ekzekutive .....	6
1. Informacion i përgjithshëm për Prokurorin e Shtetit .....	7
1.1 Struktura organizative e Prokurorit të Shtetit .....	7
1.2 Numri i prokurorëve .....	8
1.3 Ngritura e kapaciteteve profesionale të prokurorëve .....	9
1.4 Angazhimi i prokurorëve të shtetit në komisione, grupe punuese dhe panele të ndryshme .....	10
1.5 Sfidat .....	10
2. Të arriturat kryesore të Prokurorit të Shtetit gjatë gjashtëmujorit të parë 2023 .....	10
3. Rezultatet e punës së PSH-së për vepra penale specifike .....	14
3.1 Hetimi dhe ndjekja e kryerësve të veprave terroriste .....	14
3.2 Trajtimi i rasteve të krimeve të luftës .....	14
3.3 Krimi i organizuar .....	14
3.4 Rastet e shënjestruara në databazën e PSRK-së .....	14
3.5 Performanca e Prokurorit të Shtetit në luftën kundër korruptionit dhe krimeve ekonomike .....	15
3.6 Performanca e Prokurorit të Shtetit në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore .....	16
3.7 Progresi në fushën e sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë së krijuar me vepër penale .....	16
4. Përbajtja e raportit të punës së Prokurorit të Shtetit për gjashtëmujorin e parë 2023 .....	16
4.1 Kallëzimet – lëndët penale në punë .....	17
4.2 Lëndët e bartura nga viti 2022 në gjashtëmujorin e parë 2023 .....	18
4.3 Lëndët e pranuara në gjashtëmujorin e parë 2023 .....	19
4.4 Lëndët e zgjidhura .....	19
4.5 Lëndët e pazgjidhura .....	22
4.6 Lëndët në punë të zgjidhura dhe të pazgjidhura .....	22
4.7 Krahasimi i lëndëve të pranuara dhe të zgjidhura mes gjashtëmujorit të parë 2022 dhe 2023 .....	23
4.8 Trajtimi i rasteve me procedura alternative dhe të veçanta .....	25
5. Parashtruesit e kallëzimeve penale .....	25
5.1 Parashtruesit e kallëzimeve penale të kryesve madhor të veprave penale (PP) .....	26
5.2 Parashtruesit e kallëzimeve penale të kryesve të mitur të veprave penale (PPM) .....	26
5.3 Kallëzimet penale sipas prokurorive .....	27
6. Lëndët – kallëzimet penale në punë sipas prokurorive .....	28
6.1 Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit .....	28
6.1.1 Vendimet e Kryeprokurorit të Shtetit .....	29

6.2 Prokuroria e Apelit .....	30
6.3 Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës .....	31
6.4 Prokuroria Themelore në Prishtinë.....	32
6.4.1 Njësiti për Krimë Ekonomike dhe Korrupsion.....	35
6.5 Prokuroria Themelore në Gjilan.....	36
6.6 Prokuroria Themelore në Prizren.....	38
6.7 Prokuroria Themelore në Pejë .....	41
6.8 Prokuroria Themelore në Ferizaj .....	44
6.9 Prokuroria Themelore në Gjakovë.....	47
6.10 Prokuroria Themelore në Mitrovicë .....	49
7. Kallëzimet penale sipas departamenteve në kuadër të prokurorive themelore.....	52
7.1. Departamentet e krimeve të rënda të prokurorive themelore .....	56
7.1.1. Mënyra e zgjidhjes së kallëzimeve penale të kryerësve madhorë të veprave penale (PP) nga DKR-të .....	59
7.1.2 Vendimet gjyqësore përkitazi me aktet akuzuese të prokurorëve.....	60
7.2. Departamentet për të mitur të prokurorive themelore .....	60
7.2.1 Mënyra e zgjidhjes së kallëzimeve penale të kryesve të mitur të veprave penale (PPM) në DM 64	
7.2.2 Vendimet gjyqësore përkitazi me propozimet e prokurorëve për të mitur .....	64
7.3. Departamentet e përgjithshme të prokurorive themelore .....	65
7.3.1. Mënyra e zgjidhjes së kallëzimeve penale të kryerësve madhorë të veprave penale (PP) nga DP .....	68
7.3.2. Vendimet gjyqësore përkitazi me aktet akuzuese të prokurorëve.....	69
8. Ngarkesa e prokurorëve dhe prokurorive me lëndë .....	69
9. Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave .....	74
10. Njësia Ndërlidhëse për Përgjimet .....	74

## Shkurtesat

PSH	..... Prokurori i Shtetit
KPK	..... Këshilli Prokurorial i Kosovës
ZKPSH	..... Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit
PA	..... Prokuroria e Apelit
PSRK	..... Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
PTH	..... Prokuroria Themelore
DKR	..... Departamenti i Krimeve të Rënda
NJSHP	..... Njësiti për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë
DM	..... Departamenti për të Mitur
DP	..... Departamenti i Përgjithshëm
PP	..... Regjistri për evidencat e kryerësve madhorë të veprave penale
PPS	..... Regjistri i PSRK-së për evidencat e kryerësve madhorë të veprave penale
PPM	..... Regjistri për evidencat e kryerësve të mitur të veprave penale
PPN	..... Regjistri për evidencat e lëndëve të ndryshme penale
PPP	..... Regjistri për evidencat e kryerësve të panjohur të veprave penale
NJN	..... Regjistri për evidencat e ndihmës juridike ndërkontëtare
PPA	..... Ankesat në aktgjykime
KML	..... Kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë
KMLR	..... Kërkesat për revizione civile
KZJD	..... Kërkesat për zbutjen e dënimit
PAR	..... Ankesat në paraburgim
KKLKE	..... Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik

## Përbledhje ekzekutive

Puna e Prokurorit të Shtetit është transparente e cila shprehet përmes publikimit të raporteve, informatave dhe lajmeve për rastet e ndryshme specifike, të cilat pasqyrojnë punën e prokurorit dhe prokurorive. Raporti i Punës së Prokurorit të Shtetit për gjashtëmujorin e parë 2023, ofron të dhëna të detajuara dhe gjithëpërfshirëse të punës, të cilat kanë për qëllim që të njoftojnë opinionin publik me rezultatet e punës së prokurorive dhe aktivitetet të tjera, përfshirë edhe sfidat me të cilat është përballur PSH-ja gjatë kësaj periudhe kohore.

Raporti gjashtëmujor i punës për vitin 2023, përmban aktivitetet kryesore të këtij institucioni me fokus në pasqyrimin e punës së institucionit përmes të dhënavë statistikore, analitike dhe krahasuese të realizuara gjatë periudhës raportuese.

Raporti ofron informacion të përgjithshëm për punën e Prokurorit të Shtetit, përfshirë numrin e prokurorëve. Gjithashtu, pasqyron kallëzimet – lëndët penale të trashëguara, të pranuara në punë dhe ato të kryera nga ana e prokurorëve në të gjitha nivelet e sistemit prokurorial, departamentet përkatëse të prokurorive, parashtuesit e këtyre kallëzimeve, përfshirë krahasimet me vitin paraprak. Në këtë aspekt, pasqyrohet edhe numri i kallëzimeve penale të pranuara për kryerësit madhorë, kryerësit e mitur dhe kryerësit e panjohur të veprave penale.

Po ashtu në raport pasqyrohet diferenca e numrit të lëndëve të pranuara në tri departamentet e prokurorive themelore në gjashtëmujorin e parë të vitit 2023 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022.

Në periudhën raportuese, Prokurori i Shtetit, në përbushjen e mandatit të tij është ballafaquar edhe me sfida të shumta, siç janë: procesi i plotësimit të pozitave të lira për prokurorë, numri i lëndëve të trashëguara nga vitet paraprake me kryes të panjohur dhe sfida tjera.

Përkundër këtyre sfidave të shfaqura në këtë periudhë, Prokurori i Shtetit ka arritur të tregojë një performancë të mirë.

## 1. Informacion i përgjithshëm për Prokurorin e Shtetit

Prokurori i Shtetit është institucion kushtetues, i pavarur, i paanshëm me mandat dhe përgjegjësi për hetimin dhe ndjekjen e kryesve të dyshuar të veprave penale siç është përcaktuar me ligj. Prokurori i Shtetit mandatin e tij e realizon duke u bazuar në Kushtetutë dhe ligj, sipas strukturës dhe kompetencave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.


Prokurorët e shtetit janë të autorizuar që të përfaqësojnë interesat publike para gjykatave të Republikës së Kosovës dhe për të kërkuar nga gjykata që të urdhërojë masa në pajtim me Kodin e Procedurës Penale.

Ligji për Prokurorin e Shtetit përcakton strukturën, funksionet dhe përgjegjësitë e tij, që, ndër tjera, përfshijnë: ushtrimin e funksioneve prokuroriale në mënyrë të pavarur, të drejtë, objektive dhe të paanshme, të sigurohen të gjithë personat për trajtim në mënyrë të barabartë, të zbatohen standarde më të larta të kujdesit gjatë kryerjes së funksioneve zyrtare, të ketë sjellje të ndershme dhe profesionale në jetën personale dhe profesionale, duke u bazuar në ligjet e zbatueshme dhe kodin e etikës profesionale, mbrojtjen e të drejtave ligjore të viktimate, dëshmitarëve, të dyshimtëve, të akuzuarve dhe personave të dënuar, si dhe në ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme juridike për zbulimin e veprave penale dhe të autorëve të krimtit, hetimin dhe ndjekjen me kohë të veprave penale.

### 1.1 Struktura organizative e Prokurorit të Shtetit

Prokurori i Shtetit në Republikën e Kosovës ka këtë strukturë organizative:

- Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit si instanca më e lartë e Prokurorit të Shtetit, me kompetencë në tërë territorin e Republikës së Kosovës;
- Prokuroria e Apelit si shkallë e dytë me kompetencë në tërë territorin e Republikës së Kosovës;
- Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës si organ prokurorial i specializuar me juridikcion në tërë territorin e Republikës së Kosovës;
- Prokuroritë themelore të shtrira në territorin e shtatë (7) rajoneve të Kosovës.



Grafikoni 1: Struktura organizative e Prokurorit të Shtetit

## 1.2 Numri i prokurorëve

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, numri i përgjithshëm i prokurorëve në Prokurorin e Shtetit ka qenë 198. Nga numri i përgjithshëm i prokurorëve 116 apo 58,58% janë meshkuj dhe 82 apo 41,42% janë femra, ndërsa sa i përket përbërjes etnike, 183 ose 92,42% janë shqiptarë, 13 ose 6,56% serb dhe 2 ose 1,0% të etnive tjera.

Po ashtu gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023 janë avancuar tre (3) prokurorë në Prokurorinë e Apelit, pesë (5) prokurorë në Departamentin e Krimeve të Rënda në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, dhe një (1) prokuror të eshtë avancuar në DKR Prizren.

Në vijim paraqitet numri i prokurorëve në ZKPSH, PA, PSRK dhe prokuroritë themelore gjatë periudhës reportuese:

	ZKPSH	Apeli	PSRK	Prishtinë	Prizren	Pejë	Gjilan	Mitrovicë	Gjakovë	Ferizaj	Gjithsej
Kryeprokurorë	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	10
DKR		3		11	5	6	5	5	2	5	42
DM				5	2	2	1	2	1	1	14
DP		6		34	14	8	9	12	12	13	108
Prokurorë	8		16								24
Gjithsej	9	10	17	51	22	17	16	20	16	20	198

Tabela 1: Numri i prokurorëve në ZKPSH, PA, PSRK dhe PTH-ve, sipas departamenteve

### 1.3 Ngritja e kapaciteteve profesionale të prokurorëve


Prokurorët e shtetit kanë marrë pjesë në trajnime në gjashtëmujorin e parë të vitit 2023, në komponentët kryesore të programit të trajnimit të organizuara nga Akademia e Drejtësisë (AD), Ambasada Amerikane në Prishtinë, Zyra e BE-së etj. Prokurorët kanë marrë pjesë në Programin e Trajnimit të Vazhdueshëm dhe aktivitete tjera si në punëtori, tryeza, konferenca etj., ndërsa prokurorët e rinj të sapo dekretuar, kanë marrë pjesë në Programin e trajnimeve fillestare.

Gjatë kësaj përudhe prokurorët kanë marrë pjesë në (56) tema të trajnimit, ndër të cilat ka mbizotëruar: E drejta penale materiale dhe procedurale, të drejtat e njeriut në kontekst të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut. Nga trajnimet e specializuara prokurorët kanë marrë pjesë në Programet: krimi i organizuar, trafikimi i qenieve njerëzore, krimet financiare, terrorizmi, krimi kibernetike, dëshmitarët, bashkëpunimi juridik ndërkombëtar, korrupsioni, forenzika, etj.

Në koordinim të NJSHP-së, prokurorët kanë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme të arsimimit ligjor, ku prej 198 prokurorëve sa kanë qenë në periudhën raportuese, në trajnimet të vazhdueshme dhe për avancim, numri i përgjithshëm i pjesëmarrjes së prokurorëve në trajnime është 336 si në vijim:

- Prokurorët nga ZKPSH kanë ndjekur (5%) trajnime,
- Prokurorët nga PA kanë ndjekur (4%) trajnime,
- Prokurorët nga PSRK kanë ndjekur (18%) trajnime
- Prokurorët nga PTH e Prishtinës kanë ndjekur (25%) trajnime,
- Prokurorët nga PTH e Prizrenit kanë ndjekur (17%) trajnime,
- Prokurorët nga PTH e Pejës kanë ndjekur (11%) trajnime,
- Prokurorët nga PTH e Mitrovicës kanë ndjekur (3%) trajnime,
- Prokurorët nga PTH e Gjilanit kanë ndjekur (9%) trajnime,
- Prokurorët nga PTH e Gjakovës kanë ndjekur (8%) trajnime,
- Prokurorët nga PTH e Ferizajt kanë ndjekur (9%) trajnime.

Në trajnimet e prokurorëve, në cilësinë e trajnuesve ishin të angazhuar gjithsej 14 prokurorë, ndërsa pjesëmarrja e prokurorëve në trajnime shprehur në përqindje është si në grafikonin më poshtë;



Grafikoni 2: Pjesëmarrja e prokurorëve në trajnime sipas prokurorive

## 1.4 Angazhimi i prokurorëve të shtetit në komisione, grupe punuese dhe panele të ndryshme

Prokurorët e Shtetit gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, kanë qenë të angazhuar në shumë komisione në proceset e rekrutimit të Prokurorëve të Shtetit, procese të avancimit dhe transferimit të prokurorëve dhe pjesëmarrjen në grupe punuese, të cilat janë zhvilluar gjatë kësaj periudhe, panele disiplinore, si dhe shumë aktivitete tjera në funksion të zhvillimit të rregullt të proceseve në kuadër të sistemit prokurorial.

Prokurorët e Shtetit kanë shërbyer në komisione të themeluara nga Këshilli Prokurorial i Kosovës si komisione të përhershme, siç janë: Komisioni për Çështje Normative, Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel, Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve, Komisioni për Administrimin e Prokurorive, Komisioni për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit strategjik, Komisioni për monitorimin e mediave dhe komisione të tjera të përcaktuara nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Një angazhim të veçantë kanë pasur prokurorët edhe duke qenë pjesë e grupeve punuese për hartim të legjislacionit dhe akteve nënligjore të sistemit prokurorial si dhe kanë përfaqësuar sistemin prokurorial në kuadër të aktiviteteve të institucioneve shtetërore të ndërlidhura me punën e sistemit prokurorial.

## 1.5 Sfidat


Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, Prokurori i Shtetit është ballafaquar me sfida të ndryshme në përbushjen e mandatit ligjor. Ndër sfidat kryesore veçohen si më poshtë:

- Numri i lëndëve të trashëgaura nga vitet paraprake me kryes të panjohur (PPP);
- Zbatimi i Sistemit Elektronik për Menaxhimin e Lëndëve (SMIL);
- Trajtimi i rasteve të krimeve të luftës, korruptionit, krimit financiar dhe ekonomik;
- Koordinimi i aktiviteteve të Ekipit të Përbashkët për Shënjestrimin e Rasteve;
- Zhvillimi i kapaciteteve profesionale të prokurorëve të shtetit dhe stafit;
- Kapacitetet e pamjaftueshme të përkthimit nga gjuha shqipe në atë serbe dhe anasjelltas;
- Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë së krijuar me vepër penale;
- Trajtimi i rasteve përmes zbatimit të procedurave alternative;
- Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar;


## 2. Të arriturat kryesore të Prokurorit të Shtetit gjatë gjashtëmujorit të parë 2023

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, Prokurori i Shtetit ka pasur në punë një numër të madh të rasteve, si lëndë të bartura apo të pranuara brenda periudhës raportuese. PSH-ja është angazhuar maksimalisht për zgjidhjen e rasteve, veçmas rasteve të përcaktuara me prioritet sipas strategjive dhe politikave të Këshillit dhe PSH-së.


Në këtë pjesë do të paraqiten disa të dhëna, të cilat në mënyrë të përgjithësuar tregojnë për disa nga të arriturat më kryesore të PSH-së gjatë gjashtëmujorit të parë 2023, ndërsa të dhënrat e tjera që përmban ky raport janë dhënë në mënyrë të detajuar më poshtë.



Grafikoni 3: Disa nga të arriturat kryesore të PSH-së, për numrin e lëndëve në punë dhe të zgjidhura




Grafikoni 4: Efikasiteti i PSH-së, i treguar në nivel themelor




Grafikoni 5: Efikasiteti i PSH-së, në zgjidhjes së rasteve sipas natyrës së lëndëve

## Raporti i punës së PSH-së për gjashtëmujorin e parë 2023



Grafikoni 6: Efikasiteti i PSH-së, i treguar për veprat penale karakteristike



Grafikoni 7: Efikasiteti i PSH-së, sipas vendimeve gjyqësore

### 3. Rezultatet e punës së PSH-së për vepra penale specifike

Prokurori i Shtetit gjatë gjashtëmujorit të parë 2023, i ka kushtuar rëndësi mjaft të madhe zgjidhjes së rasteve që kanë të bëjnë me disa vepra penale më specifike, siç janë:

- Terrorizmi;
- Krimet e luftës;
- Krimi i organizuar;
- Rastet e shënjestruara në databazën e PSRK-së;
- Korrrupsioni dhe krimet ekonomike;
- Trafikimi i qenieve njerëzore dhe
- Konfiskimi dhe sekuestrimi i pasurisë së fituar me vepër penale.

#### 3.1 Hetimi dhe ndjekja e kryerësve të veprave terroriste

Prokurori i Shtetit gjatë gjashtëmujorit të parë 2023 ka trajtuar me prioritet të lartë rastet e terrorizmit. Gjatë kësaj periudhe PSH-ja nga regjistri i lëndëve PPS, ka pranuar 6 raste me 21 persona, ndërsa po gjatë kësaj periudhe nga PPS janë zgjidhur 3 raste me 7 persona.

#### 3.2 Trajtimi i rasteve të kimeve të luftës

Gjatë vitit 2015, në kuadër të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës është formuar Departamenti për Krime të Luftës.

Si rezultat i angazhimit të prokurorëve të këtij departamenti gjatë periudhës raportuese, nga regjistri i lëndëve PPS, PPN dhe PPP ka pasur të bartura nga viti paraprak gjithsej 1,217 lëndë, ka pranuar në punë 17 raste të reja dhe ka zgjidhur 10 raste.

Mënyra e zgjidhjes së rasteve është si në vijim:

Në 4 raste ndaj 4 personave – Aktakuzë (PPS);

Në 2 raste ndaj 9 personave – në mënyrë tjetër (bashkuar me rast tjetër/veçim i lëndës);

Në 2 raste – Raport për mbyllje (PPN);

Në 2 raste - Rastet kanë kaluar në rexhistrin PPS (nga rexhistri PPN dhe PPP);

#### 3.3 Krimi i organizuar

Prokurori i Shtetit gjatë gjashtëmujorit të parë 2023 ka trajtuar me prioritet të lartë rastet e krimit të organizuar. Prokurori i Shtetit ka pasur në punë lëndë me kryes të njohur madhor (PP) dhe lëndë të ndryshme penale (PPN) gjithsej 71 raste me 479 persona, prej të cilave të pranuara si raste të reja janë 8 me 72 persona. Prej tyre janë zgjidhur 5 raste me 15 persona, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 66 raste me 469 persona.

#### 3.4 Rastet e shënjestruara në databazën e PSRK-së

Me vendimin e Kryeprokurorit të Shtetit të datës 28.12.2015 është themeluar Ekipi i përbashkët për përzgjedhjen dhe shënjestrimin e kimeve të rënda në përbërje të

përfaqësuesve të institucioneve për zbatimin e ligjit, siç janë: Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës, Njësia për Inteligjencë Financiare, Agjencia për Menaxhimin e Aseteve të Sekuestruara ose të Konfiskuara dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës.

Prokurori i Shtetit ka krijuar një bazë të dhënave që përmban informata për lëndët e shënjestruara të krimit të organizuar dhe korruptionit të nivelit të lartë. Deri më sot, kjo bazë e të dhënave përfshinë të dhënat për 88 lëndë me 784 persona në rastet e krimit të organizuar dhe korruptionit.

Gjatë gjashtëmujorit të parë 2023 janë shënjestruar 4 raste me 57 persona.

Krijimi i këtij ekipi nga ana e Kryeprokurorit të Shtetit ka për qëllim që t'i jepet prioritet lëndëve të kimeve të rënda dhe korruptionit të nivelit të lartë, i cili edhe ka treguar sukses të pakontestueshëm.

### 3.5 Performanca e Prokurorit të Shtetit në luftën kundër korruptionit dhe kimeve ekonomike

Trajtimi i lëndëve të korruptionit ishte ndër prioritetet kryesore të Prokurorit të Shtetit për gjashtëmujorin e parë 2023. Realizimit të këtij prioriteti i ka kontribuar edhe zbatimi i Planit Strategjik (2022-2024) dhe plani i veprimit për ngritjen e efikasitetit në luftimin e korruptionit dhe kimeve ekonomike. Mbështetje zbatimit të këtij plani i ka dhënë Njësiti për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimit Ekonomik në kuadër të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, veprimet e të cilët janë mbikëqyrur nga një Komision i veçantë, i themeluar nga Këshilli.

Si rezultat i veprimeve të Prokurorit të Shtetit në zgjidhjen e lëndëve të korruptionit gjatë gjashtëmujorit të parë 2023 kemi të dhënat si në vijim:

Lëndë në prokurori	Korrupsioni				Krimet ekonomike			
	PP		PPN		PP		PPN	
	Kall. penale	Persona	Kall. penale	Persona	Kall. penale	Persona	Kall. penale	Persona
Të pranuara	317	676	240	368	194	287	69	72
Të zgjidhura %	236	479	182	294	133	211	45	50
	74,44%	70.85%	75.83%	79.89%	68.55%	73.51%	65.21%	69.44%
Të pazgjidhura	554	1534	803	1200	452	637	149	174

Tabela 2: Të dhënat lidhur me të arriturat e PSH në luftën kundër korruptionit dhe krimit ekonomik

### 3.6 Performanca e Prokurorit të Shtetit në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore

Kryeprokurori i Shtetit me qëllim të ngritjes së efikasitetit në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, ka emëruar një koordinator për luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore, i cili është pjesë e Autoritetit Kombëtar kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Në këtë drejtim, institucioni i Prokurorit të Shtetit ka qenë pjesë aktive e të gjithë mekanizmave për luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore, si pjesë e strategjive dhe politikave shtetërore.

Prokurori i Shtetit ka trajtuar me prioritet rastet e trafikimit të qenieve njerëzore. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, Prokurori i Shtetit për kryerësit madhorë kishte në punë 64 raste me 115 persona. Prej tyre janë zgjidhur 28 raste me 43 persona, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 36 raste me 72 persona.

Ndërsa nga regjistri PPN, kishe në punë 4 raste me 7 persona, dhe të pazgjidhura kanë mbetur 3 raste me 6 persona.

### 3.7 Progresi në fushën e sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë së krijuar me vepër penale

Me qëllim të ngritjes së efikasitetit në luftimin e krimeve ekonomike, në veçanti në sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme në kuadër të sistemit prokurorial është caktuar Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik (KKLKE).

Si rezultat i qasjes shumëdimensionale dhe koordinimit ndërinstitucional nga KKLKE-ja, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023 janë shënuar rezultate tejet të larta në fushën e sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë së krijuar me vepër penale. Kështu sipas të dhënavë për këtë gjashtëmujor gjithsej janë ngrirë dhe sekuestruar 65,310,526.98 € dhe janë konfiskuar 3,594,635,64 € pasuri.

## 4. Përbajtja e raportit të punës së Prokurorit të Shtetit për gjashtëmujorin e parë 2023

Raporti i punës së Prokurorit të Shtetit për gjashtëmujorin e parë 2023 paraqet punën e Prokurorit të Shtetit të realizuar gjatë periudhës janar qershori nga të gjitha prokuroritë e Kosovës. Ky raport është hartuar duke u bazuar në të dhënat statistikore të përgatitura nga prokuroritë, të përpunuara në nivel vendi nga zyrat përkatëse në kuadër të sistemit prokurorial.

Raporti ka një strukturë, e cila iu mundëson lexuesve që të orientohen dhe të kuptojnë lehtësisht proceset e punës së Prokurorit të Shtetit dhe të informohen për rezultatet e punës, duke i paraqitur ato në mënyrë të thjeshtësuar, nga disa këndvështrime.

Në këtë raport, puna e Prokurorit të Shtetit është paraqitur sipas strukturës si më poshtë:

- Raporti i punës sipas numrit të kallëzimeve-lëndëve penale të bartura nga viti paraprak, të pranuara, gjithsej në punë, të zgjidhura dhe të pazgjidhura;
- Raporti për parashtruesit e kallëzimeve penale;
- Raporti i punës sipas prokurorive;
- Raporti i punës sipas departamenteve dhe
- Raporti i punës sipas efikasitetit të prokurorive;

#### 4.1 Kallëzimet – lëndët penale në punë

Prokurori i Shtetit (PSH) gjatë periudhës së gjashtëmujorit të parë 2023 ka pasur në punë gjithsejtë 115,059 kallëzime – lëndë penale (regjistrat: PP, PPM, PPN, NJN, PPP, lëndët e PA-së dhe ZKPSH-së).

Nga ky numër i lëndëve:


- 88,703 ose 77.09% janë të trashëguara/bartura si lëndë të pazgjidhura nga vitet paraprake; dhe
- 26,356 ose 22,90% janë pranuar në punë gjatë gjashtëmujorit të parë 2023;

Gjatë këtij viti, nga ky numër i lëndëve:

- 20,207 ose 17.56%<sup>1</sup> e lëndëve në punë gjatë gjashtëmujorit të parë 2023, janë zgjidhur apo proceduar në organet kompetente;
- 94,852 ose 82.43% e të gjitha lëndëve në punë kanë mbetur pa u zgjidhur;

Efikasiteti i lëndëve të zgjidhura gjatë gjashtëmujorit të parë 2023 është:

- 20,207 kallëzime – lëndë penale janë zgjidhur gjithsej;
- 6,149 kallëzime – lëndë penale janë zgjidhur më pak se që janë pranuar, apo 23.33% kallëzime/lëndë penale janë zgjidhur më pak se që janë pranuar.




Grafikoni 8: Numri i lëndëve në punë, të bartura të pranuara, të zgjidhura dhe të pazgjidhura gjatë gjashtëmujorit të parë 2023

<sup>1</sup> Në këtë numër të lëndëve të zgjidhura hyjnë edhe lëndët e trashëguara nga vitet paraprake.

## 4.2 Lëndët e bartura nga viti 2022 në gjashtëmujorin e parë 2023

Nga viti 2022 në gjashtëmujorin e parë 2023 janë bartur gjithsej 88,703 lëndë-kallëzime penale në të gjitha departamentet dhe sipas të gjithë regjistrave të prokurorive. Sipas regjistrave për të gjitha llojet e kallëzimeve-lëndëve penale, gjendja e lëndëve të bartura është si më poshtë:

- 8,769 kallëzime penale të kryesve madhor (PP) të veprave penale ose 9,88%;
- 681 kallëzime penale të kryesve të mitur (PPM) të veprave penale ose 0,76%;
- 66,768 lëndë penale me kryes të parnjohur (PPP) të veprave penale ose 75.27%;
- 11,860 lëndë të ndryshme penale (PPN) ose 13,37%;
- 610 lëndë e ndihmës juridike ndërkomëtare (NJP) ose 0,68%;
- 0 lëndë në Prokurorinë e Apelit (PA) ose % dhe
- 15 lëndë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH) ose 0,01%.




Grafikoni 9: Kallëzimet- lëndët penale të bartura nga viti 2022

#### 4.3 Lëndët e pranuara në gjashtëmujorin e parë 2023

Gjatë gjashtëmujorit të parë 2023 janë pranuar në punë 26,356 kallëzime-lëndë penale, prej të cilave sipas regjistrave në Prokurorin e Shtetit, janë si më poshtë:

- 11,460 kallëzime penale të kryesve madhor (PP) të veprave penale ose 43.48%;
- 944 kallëzime penale të kryesve të mitur (PPM) të veprave penale ose 3,58%;
- 4,201 lëndë penale me kryes të panjohur (PPP) të veprave penale ose 15.93%;
- 4,793 lëndë të ndryshme penale (PPN) ose 18,18%;
- 163 lëndë e ndihmës juridike ndërkomëtare (NJP) ose 0,61%;
- 4,125 lëndë në Prokurorinë e Apelit (PA) ose 15,65% dhe
- 670 lëndë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH) ose 2,54%.



Grafikoni 10: Kallëzimet – lëndët penale të pranuara në punë gjatë gjashtëmujorit të parë 2023


#### 4.4 Lëndët e zgjidhura

Në gjashtëmujorin e parë 2023, Prokurori i Shtetit ka pasur një angazhim mjaftë të lartë në punë, si rezultat i të cilës janë kryer një numër madh i lëndëve, veçanërisht në raport me lëndët e pranuara gjatë kësaj periudhe kohore. Nga gjithsej 20,207 kallëzime-lëndë penale që janë zgjidhur gjithsej, sipas regjistrave të prokurorive përfshirë këtu edhe ZKPSH-në, Prokurorinë e Apelit dhe PSRK-në, pasqyrohet situata si më poshtë:

- 9,641 kallëzime penale të kryesve madhor (PP) të veprave penale ose 47,71 %;
- 696 kallëzime penale të kryesve të mitur (PPM) të veprave penale ose 3,44%;
- 1,358 lëndë penale me kryes të panjohur (PPP) të veprave penale ose 6,72%;


## Raporti i punës së PSH-së për gjashtëmujorin e parë 2023

- 3,403 lëndë të ndryshme penale (PPN) ose 16,84%;
- 322 lëndë e ndihmës juridike ndërkomëtare (NJN) ose 1,59%;
- 4,125 lëndë në Prokurorinë e Apelit (PA) ose 20,41 %, dhe
- 662 lëndë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH) ose 3,27%.




Grafikoni 11: Kallëzimet - lëndët penale të zgjidhura gjatë gjashtëmujorit të parë 2023

Norma e zgjidhjes së lëndëve nga Prokurori i Shtetit në gjashtëmujorin e parë 2023 sipas indikatorëve të CEPEJ paraqitet si më poshtë:




Grafikoni 12: Norma e zgjidhje së lëndëve nga Prokuroi i Shtetit në gjashtëmujorin e vitit 2023 sipas indikatorëve të CEPEJ

Krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2022-2023 norma e zgjidhjes së lëndëve po sipas indikatorëve të CEPEJ, paraqitet si më poshtë:



Grafikoni 13: Norma e zgjidhje së lëndëve nga Prokurori i Shtetit 2022 v. 2023 sipas indikatorëve të CEPEJ

Ndërsa, krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2021 dhe 2023, norma e zgjidhjes së lëndëve po sipas indikatorëve të CEPEJ, paraqitet si më poshtë:




Grafikoni 14: Norma e zgjidhje së lëndëve nga Prokurori i Shtetit 2021 v. 2023 sipas indikatorëve të CEPEJ

#### 4.5 Lëndët e pazgjidhura

Në fund të gjashtëmujorit të parë 2023, të pazgjidhura kanë mbetur **94,852** kallëzime-lëndë penale, prej të cilave janë:


- 10,588 kallëzime penale të kryesve madhor (PP) të veprave penale ose 11,16%;
- 929 kallëzime penale të kryesve të mitur (PPM) të veprave penale ose 0,97%;
- 69,611 lëndë penale me kryes të panjohur (PPP) të veprave penale ose 73,38%
- 13,250 lëndë të ndryshme penale (PPN) ose 13,96%;
- 451 lëndë e ndihmës juridike ndërkomëtare (NJJN) ose 0,47%;
- 0 lëndë në Prokurorinë e Apelit (PA) ose 0,00%, dhe
- 23 lëndë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH) ose 0,02%;



Grafikoni 15: Kallëzimet- lëndët penale të pazgjidhura në fund të gjashtëmujorit të parë 2023

#### 4.6 Lëndët në punë të zgjidhura dhe të pazgjidhura

Numri i kallëzimeve-lëndëve penale në punë, të zgjidhura dhe ato të mbetura në fund të gjashtëmujorit të parë 2023, sipas regjistrave pasqyrohen në grafikonin në vijim.



Grafikoni 16: Kallëzimet – lëndët penale në punë, të zgjidhura dhe të pazgjidhura në gjashtëmujorin e parë 2022


Sipas pasqyrimit në grafikonin 16, numri më i madh i kallëzimeve-lëndëve penale në punë i përket:

- Kryesve të panjohur të veprave penale (PPP), me 70,969 ose 61.68%;
- Kryesve madhor të veprave penale (PP), me 20,229 ose 17.58%;
- Lëndë të ndryshme penale (PPN), me 16,653 ose 14.47%.
- Kallëzimet penale të kryesve të mitur (PPM), me 1,625 ose 1.41%;
- Lëndët penale të Prokurorisë së Apelit me 4,125 ose 3.58%;
- Lëndët e ZKPSH-së 685 ose me 0,59%.
- Lëndët e ndihmës juridike ndërkontaktare (NJJN) 773 ose me 0,67%.

Nga ky grafikon shihet se nuk ekziston trendi i njëjtë i numrit të lëndëve që janë në punë sipas llojit dhe atyre të zgjidhura. Përkundër se numri më i madh i lëndëve në punë është nga regjistri PPP, numri më i madhe i lëndëve të zgjidhura është nga regjistri PP me 17.58%.

#### 4.7 Krahasimi i lëndëve të pranuara dhe të zgjidhura mes gjashtëmujorit të parë 2022 dhe 2023

Në grafikonin në vijim pasqyrohet krahasimi i kallëzimeve-lëndëve penale (PP, PPM, PPN, PPP) të pranuara dhe të zgjidhura në mes të gjashtëmujorit të parë 2022-2023:



Grafikoni 17: Krahasimi i lëndëve të pranuara në punë dhe të zgjidhura në mes të gjashtëmujorit të parë 2022-2023 për registrat PP, PPM, PPN dhe PPP

Numri i kallëzimeve penale të kryesve madhor (PP) të pranuara në punë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022, *është zvogëluar* për 881 kallëzime penale ose 7.13%. Ndërsa numri i kallëzimeve penale të kryesve madhor (PP) të zgjidhura gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022, *është zvogëluar* për 1,048 kallëzime penale ose 9.80%.

Numri i kallëzimeve penale të kryesve të mitur (PPM) të pranuara në punë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022, *është rritur* për 13 kallëzime penale ose 1.39%. Ndërsa numri i kallëzimeve penale të kryesve të mitur (PPM) të përfunduara gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022, *është zvogëluar* për 191 kallëzime penale ose 21.53%.


Numri i lëndëve penale të ndryshme (PPN), të pranuara në punë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022, *është rritur* për 129 ose 2.76% të lëndëve. Ndërsa numri i lëndëve penale të ndryshme (PPN), të përfunduara gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022, *është zvogëluar* për 793 ose për 18.89% të lëndëve.

Numri i lëndëve me kryes të panjohur të veprave penale (PPP), të pranuara në punë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022, *është zvogëluar* për 305 ose 6.76%. Ndërsa numri i lëndëve me kryes të panjohur të veprave penale (PPP), të përfunduara gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022, *është zvogëluar* për 222 ose 14.05%.

#### 4.8 Trajtimi i rasteve me procedura alternative dhe të veçanta

Trajtimi i rasteve me procedura alternative synon dhënien e drejtësisë në një kohë sa më të arsyeshme dhe shkarkimin e prokurorëve nga barra e numrit të madh të lëndëve. Në këtë funksion është edhe procedura e veçantë për dhënien e urdhrit ndëshkimor.

Si rezultat i punës, Prokurori i Shtetit ka zgjidhur 1070 raste me 1,554 persona gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, 26 raste me 34 persona me pezullim të përkohshëm të procedurës (neni 230), 20 raste me 21 persona sipas kushteve kur ndjekja nuk është e detyrueshme (neni 231), 872 raste me 1,319 persona në procedurën e ndërmjetësimit (neni 232), 152 raste me 180 persona me aktakuzë për marrëveshjen e pranimit të fajësisë (neni 233).



Grafikoni 18: Lëndët e zgjidhura me procedura alternative dhe procedura të veçanta

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se nga numri total i rasteve të pranuara në prokuroritë themelore (11,407 kallëzime penale - PP në të gjitha prokuroritë themelore) nga Prokurori i Shtetit përmes procedurave alternative, janë zgjidhur 1,070 raste apo 9.38% me 1,554 persona (nga 11,994 persona të zgjidhur) apo 12.95% të personave.


Po ashtu Prokurori i Shtetit gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, me aktakuzë me urdhër ndëshkimor ka zgjidhur gjithsejtë 1,409 raste të personave.

#### 5. Parashtuesit e kallëzimeve penale

Në këtë pjesë, do të paraqiten të dhënat lidhur me parashtuesin dhe numrin e parashtuesve të kallëzimeve penale për lëndët të cilat janë pranuar në punë gjatë gjashtëmujorit të vitit 2023.

## 5.1 Parashtruesit e kallëzimeve penale të kryesve madhor të veprave penale (PP)

Gjatë gjashtëmujorit të parë 2023, prokuroritë themelore dhe PSRK kanë pranuar në punë gjithsej 11,460 kallëzime penale me 14,779 persona madhor (PP). Këto kallëzime penale janë parashtruar nga:




Grafikoni 19: Parashtruesit e kallëzimeve penale PP

Nga të dhënat statistikore për parashtruesit e kallëzimeve penale, vërehet se numri më i madh i kallëzimeve penale është parashtruar nga Policia e Kosovës me 9,601 kallëzime penale ose 83.77%.

## 5.2 Parashtruesit e kallëzimeve penale të kryesve të mitur të veprave penale (PPM)

Departamentet për të Mitur (DM-të) të Prokurorive Themelore në periudhën raportuese kanë pranuar 944 kallëzime penale ndaj 1,416 personave të mitur.

Numri më i madh i kallëzimeve penale është parashtruar nga Policia e Kosovës me 921 kallëzime ose 97,56% nga të gjitha kallëzimet penale PPM, ndërsa të gjithë parashtruesit janë të pasqyruar në grafikonin si në vijim:



Grafikoni 20: Parashtruesit e kallëzimeve penale nga PPM

Nga ky grafikon shihet se numri i më i madh i kallëzimeve penale është parashtruar nga Policia e Kosovës me 921 kallëzime ose 97,56% nga të gjitha kallëzimet penale PPM.

### 5.3 Kallëzimet penale sipas prokurorive

Mbështetur në statistikat për numrin e kallëzimeve penale të pranuara gjatë gjashtëmujorit të parë 2023, në tabelën në vijim pasqyrohet numri i kallëzimeve penale të pranuara për kryesit madhor (PP), kryesit e mitur (PPM), lëndë të ndryshme penale (PPN) dhe kryesit e panjohur të veprave penale (PPP) sipas kompetencës territoriale të prokurorive themelore dhe PSRK-së.

PTH+PSR K	Regjistri PP		Regjistri PPM		Regjistri PPN		Regjistri PPP		Gjithsej	
	Kallëzimet e pranuara	Nr. i kryerës ve	Kallëzim et e pranuara	Nr. i kryerës ve	Kallëzim et e pranuara	Nr. i kryerës ve	Kallëzim et e pranuara	Nr. i kryerës ve	Kallëzim et e pranuara	Nr. i kryerës ve
Prishtinë	5,098	6,372	435	618	1478	NN	2277	NN	9,288	6,990
Prizren	1,151	1,533	94	151	782	NN	342	NN	2,369	1,684
Pejë	1,229	1,565	105	159	683	NN	306	NN	2,323	1,724
Gjakovë	855	1,223	98	166	513	NN	288	NN	1,754	1,389
Mitrovicë	1,066	1,297	58	78	383	NN	334	NN	1,841	1,375
Gjilan	1,109	1,340	56	73	489	NN	255	NN	1,909	1,413
Ferizaj	899	1,184	98	171	359	NN	396	NN	1,752	1,355
PSRK	53	265	0	0	106	NN	3	NN	162	265
<b>Gjithsej</b>	<b>11,460</b>	<b>14,779</b>	<b>944</b>	<b>1416</b>	<b>4793</b>	<b>NN</b>	<b>4201</b>	<b>NN</b>	<b>21,398</b>	<b>16,195</b>

Tabela 3: Kallëzimet - lëndët penale të pranuara për kryesit madhor (PP), kryesit e mitur (PPM), lëndë të ndryshme penale (PPN) dhe kryesit e panjohur (PPP) të veprave penale sipas prokurorive

## 6. Lëndët – kallëzimet penale në punë sipas prokurorive

Për të parë ngarkesën dhe rezultatet e punës së secilës prokurori gjatë gjashtëmujorit të parë 2023, do të paraqiten të dhënat si më poshtë.

### 6.1 Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, ka pasur në punë gjithsejtë 685 lëndë penale.


Prej tyre janë si më poshtë:

- 15 ose 2.18% kanë qenë lëndë të pazgjidhura nga periudhat paraprake, kurse
- 670 ose 97.81%, lëndë të pranuara në punë gjatë periudhës raportuese.

Nga numri i lëndëve në punë gjatë periudhës raportuese prokurorët në ZKPSH kanë zgjidhur 662 ose 96.64%, kurse në fund të periudhës raportuese kanë mbetur të pazgjidhura 23 lëndë ose 3.38% të lëndëve që ka pasur në punë gjatë vitit.

Nga të dhënat e prezantuara më lartë shihet se prokurorët në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit gjatë gjashtëmujorit të parë 2023 kanë zgjidhur 8 lëndë ose 0.16% lëndë më pak se sa kanë pranuar në punë.

Numri i lëndëve të pranuara në punë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022 ka shënuar rënien për 90 lëndë ose 13.13%.



Grafikoni 21: Pasqyra e lëndëve të pranuara, të bartura, të zgjidhura dhe të pazgjidhura në ZKPSH

### 6.1.1 Vendimet e Kryeprokurorit të Shtetit

Kryeprokurori i Shtetit si kreu i Prokurorit të Shtetit me përgjegjësi për menaxhimin dhe përfaqësimin e Prokurorit të Shtetit dhe të strukturave të prokurorive, ka në kompetencë të tij edhe nxjerrjen e rregullave, udhëzimeve dhe vendimeve të përgjithshme të detyrueshme për të gjithë kryeprokurorët dhe prokurorët me qëllim të zbatimit të ligjshmërisë, ngritjes së efikasitetit dhe zbatimit unik të praktikave dhe legjislacionit.

Kryeprokurori i Shtetit ka juridikcion në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe ka juridikcion ekskluziv mbi lëndët në shkallë të tretë pranë Gjykatës Supreme, si dhe mbi të gjitha lëndët që përfshijnë mjetet të jashtëzakonshme juridike. Kryeprokurori i Shtetit mund të marrë në kompetencë secilën lëndë në secilën prokurori të Republikës së Kosovës siç është përcaktuar me ligj.

Gjatë periudhës janar – qershor 2023, Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, ka marrë gjithsejtë 37 raste nga regjistri A, (Administrative) dhe 6 raste A.D (raste disiplinore);

- Ka dhënë pëlqimin për 4 raste të ndërlikuara;
- Janë pranuar 28 kërkesa nga regjistri Sekret të cilat 12 raste kanë qenë për verifikim dhe rastet e tjera u janë përcjellur prokurorive për trajtim të mëtutjeshëm të lëndëve;
- Ka caktuar Koordinatoret Nacionale për Zgjedhje
- Ka nxjerrë edhe tri (3) udhëzime të detyrueshme për prokurorët e shtetit:
- Udhëzim - Për procedurat e veprimit me rastin e shqyrtimit të ankesave kundër vendimeve të prokurorive themelore dhe PSRK-së në Prokurorinë e Apelit
- Udhëzues i thjeshtësuar për konfiskim
- Udhëzimin për zbatim të dispozitës nga nen 154 i Kodit të Procedurës Penale

Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, së bashku me Kryesuesin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, Jetish Maloku dhe Kryeprokurorin e Prokurorisë Speciale, Blerim Isufaj, kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Shefin e Zyrës së Këshillit të Evropës në Kosovë, Frank Power, për zbatimin e programit të shkëmbimit të përvojave në fushën e hetimit dhe ndjekjes penale kundër pastrimit të parave, i cili, do të implementohet në kuadër të Projektit të Përbashkët të Bashkimit Evropian / Këshillit të Evropës kundër Krimít Ekonomik (PECK III).

Gjithashtu ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Auditoren e Përgjithshme të Kosovës, znj. Vlora Spanca, e cila marrëveshje përcakton mënyrën e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve ndërinstitucionale dhe procedurave standarde në shkëmbimin e informacioneve lidhur me rastet të cilat sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës paraqesin vepra penale, që janë identikuara gjatë ushtrimit të aktiviteteve audituese, të paraqitura nga Zyra Kombëtare e Auditimit tek Prokurori i Shtetit sipas Kodit të Procedurës Penale.

Nën patronatin e U.D. Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, dhe në mbështetje të Ambasadës Amerikane në Kosovë, me 25 mars 2023 është organizuar Konferanca Vjetore e Prokurorëve.

Gjatë periudhës janar – qershor 2023, U.D. Kryeprokurori i Shtetit ka mbajtur tri (3) kolegjiume me kryeprokurorët e prokurorive dhe prokurorët e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.

U.D. Kryeprokurori i Shtetit së bashku me Drejtorin e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Ilir Murtezaj, mbështetur nga Zyra e UNDP në Kosovë, përmes Projektit SAEK III, kanë mbajtur takim të përbashkët me akterët institucionalë të Republikës së Kosovës për intensifikimin dhe bashkërendimin në funksion të zhvillimit të platformës për hetime penale mbi të dhënat inteligjente, e cila platformë derivon nga marrëveshja e përbashkët ndërmjet ZKPSH-së dhe ATK-së.

U.D. Kryeprokurori i Shtetit së bashku me bartësit e tjera të sistemit të drejtësisë ka nënshkruar - Deklaratën e përbashkët me Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin Prokurorial të Kosovës, Këshillin Gjyqësorin të Kosovës, dhe Gjykatën Supreme për reformën në drejtësi.

Gjatë periudhës raportuese janar – qershor 2023, U.D. Kryeprokurori i Shtetit ka zhvilluar takime zyrtare me përfaqësues të institucioneve vendore e ndërkombëtare dhe përfaqësues të shoqërisë civile.


## 6.2 Prokuroria e Apelit

Prokuroria e Apelit (PA), gjatë periudhës raportuese ka pasur në punë gjithsejtë 4,125 lëndë penale. Të bartura nga viti 2022 nuk ka pasur asnjë lëndë ndërsa gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, janë pranuar 4,125 lëndë ose 100% e lëndëve në punë.


Prokuroria e Apelit, gjatë periudhës raportuese nga lëndët në punë:

- 4,125 lëndë ose 100%, i ka zgjidhur, kurse
- 0 lëndë ose 0.00% kanë mbetur të pazgjidhura.

Nga lëndët në punë 1,874 ose 45.43 % janë të DKR, ndërsa 2,251 ose 54.56% i përkasin DP.



Grafikoni 22: Pasqyra e lëndëve të bartura, pranuara, zgjidhura dhe të pazgjidhura në Prokurorinë e Apelit




Grafikoni 23: Natyra e lëndëve të pranuara në Prokurorinë e Apelit

Nga lëndët në punë që ka pasur Prokuroria e Apelit në DKR, prej tyre 420 me kryes madhor, 176 me të mitur, 952 ankesa në paraburgim, dhe 326 të ndryshme. Ndërsa në DP nga 2,251 lëndë me kryes madhor ishin 839 lëndë, ankesa për paraburgim 957 dhe të ndryshme 455 lëndë.

### 6.3 Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, ka pasur në punë gjithsej 2,067 kallëzime-lëndë penale nga të gjithë regjistrat, ndërsa vetëm në regjistrin PP me kryes madhor janë 608 raste me 2,656 persona.

Prej tyre, 608 ose 29.41%, janë kallëzime penale të kryesve madhor të veprave penale (PP), kurse 1,459 ose 70.58% të lëndëve penale u përkasin kryesve të panjohur të veprave penale nga regjistri (PPP), lëndëve të ndryshme penale (PPN) dhe lëndëve të ndihmës juridike ndërkomëtare (NJP), si në tabelën në vijim:



Graf 24: Kallëzimet-lëndët penale të mbetur nga vitet paraprake, të pranuara, të zgjidhura dhe të pazgjidhura në PSRK.

Nga tabela shihet se PSRK gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, ka pranuar në punë 232 lëndë, përderisa ka zgjidhur 168 lëndë ose 72.41% të lëndëve të pranuara apo 8.12% të lëndëve që ka pasur në punë.

Në 2,067 raste në punë prej tyre janë zgjidhur 168 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 1,899 lëndë. Nga 608 kallëzime penale, me 2,656 persona si kryes të njohur (PP), prej tyre për 146 persona janë zgjidhur në këtë mënyrë:

- Aktakuza pas hetimit është ngrit ndaj 39 ose 26,71%, të personave;
- Hetimet janë pushuar ndaj 29 ose 19.86% të personave;
- Ndaj 48 ose 32.87% të personave është hedhur kallëzimi penal; dhe
- Ndaj 30 ose 20.54 % të personave janë ceduar rastet në kompetencë;

Në fund të periudhës raportuese kanë mbetur të pa përfunduara hetimet në 566 lëndë ndaj 2,510 ose 94.50%, të personave (si kryes të njohur - PP), sa ishin në punë.

#### *6.3.1 Vendimet gjyqësore përkitazi me aktet akuzuese të prokurorëve të PSRK-së*

Gjatë kësaj periudhe, gjykata duke vendosur sipas akteve akuzuese të prokurorëve të PSRK-së, kanë marrë 98 vendime gjyqësore, si në vijim:

- Kanë shpallur fajtor dhe kanë dënuar me akt gjykim fajësues 48 persona 48,97%;
- Kanë refuzuar aktin akuzues kundër 5 personave ose 5,10%;
- Kanë liruar nga akuza 42 persona ose 42,85%, dhe
- Hedhje të aktit akuzues ndaj 3 personi ose 3,06%.


Prokurorët e PSRK-së, ndaj vendimeve të gjykatave kanë parashtruar 36 ankesa përkitazi me vendimet gjyqësore nga të cilat 18 ose 50% të ankesave janë parashtruar vetëm për shkak të vendimit mbi dënimin.

## **6.4 Prokuroria Themelore në Prishtinë**

Puna e prokurorive themelore në këtë raport do të paraqitet sipas departamenteve si dhe përmes regjistrave në mënyrë që të krijohet një pasqyrë gjithëpërfshirëse për punën e tyre.

Prokuroria Themelore në Prishtinë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023 ka pasur në punë gjithsej 58,840 lëndë-kallëzime penale, nga të cilat sipas departamenteve gjendja paraqitet si më poshtë:

**Lëndë në punë dhe të zgjidhura sipas departamenteve**



Grafikoni 25: Lëndë në punë dhe të zgjidhura sipas departamenteve në PTH Prishtinë


Nga këto të dhëna shihet se Prokuroria Themelore në Prishtinë në DP ka kryer 2,828 lëndë *më pak* se sa ka pranuar apo 64.17% e lëndëve të pranuara. Në përgjithësi DP në PTH Prishtinë ka kryer 5,065 lëndë apo 9.48% të lëndëve që ka pasur në punë.

Në DKR janë kryer 275 lëndë *më shumë* se sa janë pranuar apo 129.95% e lëndëve të pranuara. Në përgjithësi DKR në PTH Prishtinë ka kryer 1,193 lëndë, apo 26.01% e lëndëve që kanë qenë në punë.

DM ka kryer 156 lëndë *më pak* se sa ka pranuar apo 69.41% e lëndëve të pranuara. Në përgjithësi DM në PTH Prishtinë ka kryer 354 lëndë, apo 41.74 % e lëndëve që kanë qenë në punë.

Sipas regjistrave situata me lëndë në punë dhe të zgjidhura qëndron si më poshtë:

### Lëndë në punë dhe të zgjidhura sipas regjistrave



Grafikoni 26: Lëndë në punë dhe të zgjidhura sipas regjistrave në PTH Prishtinë

Bazuar në të dhënat si më lartë mund të konstatojmë se në PTH Prishtinë, në regjistrin PP janë zgjidhur 1,086 lëndë *më pak* se sa janë pranuar, apo 78.69% e lëndëve të pranuara. Në total nga regjistri PP, PTH në Prishtinë janë zgjidhur 4,012 lëndë apo 47.12% e të gjitha lëndëve në punë.


Në regjistrin PPN janë zgjidhur 352 lëndë *më pak* apo 76.18% e lëndëve që janë pranuar. Në total nga regjistri PPN, PTH në Prishtinë janë zgjidhur 1,126 lëndë apo 20.56% e të gjitha lëndëve në punë.

Në regjistrin PPM janë zgjidhur 144 lëndë *më pak* se sa janë pranuar apo 66.89% e lëndëve të pranuara. Në total nga regjistri PPM, PTH në Prishtinë janë zgjidhur 291 lëndë apo 42.79% e të gjitha lëndëve në punë.

Në regjistrin PPP janë kryer 1,283 lëndë *më pak* se sa janë pranuar apo 43.63%, ndërsa gjithsej janë zgjidhur 994 lëndë apo 2,27% e të gjitha lëndëve në punë.

Në regjistrin NJN janë zgjidhur 156 lëndë *më shumë* se që janë pranuar apo 5.72%. Në total nga regjistri NJN, PTH në Prishtinë janë zgjidhur 189 lëndë apo 45.65% e të gjitha lëndëve në punë.

#### Lëndët e zgjidhura me procedura alternative:



Grafikoni 27: Lëndë të zgjidhura me procedura alternative në PTH Prishtinë

#### 6.4.1 Njësiti për Krime Ekonomike dhe Korrupsion

Në kuadër të DKR në Prokurorinë Themelore në Prishtinë funksionon edhe Njësiti për Krime Ekonomike dhe Korrupsion (Njësiti).


Në kuadër të Njësirit, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023 ka qenë në punë gjithsej 264 kallëzime penale për kryesit e njohur madhor (PP), me gjithsejtë 635 persona. Nga ky numër 95 raste me 249 persona janë bartur nga vitet paraprake, ndërsa të pranuara janë 169 kallëzime me 386 persona. Nga numri i kallëzimeve penale në punë janë zgjidhur 79 kallëzime penale me 184 persona, ndërsa në fund të periudhës raportuese, kanë mbetur të pazgjidhura 185 kallëzime me 451 persona.

Në kuadër të Njësitit gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023 kanë qenë në punë gjithsej 631 lëndë të ndryshme penale (PPN), prej të cilave të bartura kanë qenë 420 raste ndërsa të pranuara 211 raste. Sa i përket zgjidhjes së rasteve prokurorët kanë arritur që ti zgjidhin 116 raste PPN, ndërsa në fund të periudhës raportuese kanë mbetur 515 raste të pazgjidhura.

## 6.5 Prokuroria Themelore në Gjilan

Prokuroria Themelore në Gjilan gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023 ka pasur në punë gjithsej 4,232 lëndë-kallëzime penale, nga të cilat sipas departamenteve gjendja paraqitet si më poshtë:

### Lëndë në punë dhe të zgjidhura sipas departamenteve



Grafikoni 28: Lëndë në punë dhe të zgjidhura sipas departamenteve në PTH Gjilan


Nga këta grafikonë shihet se Prokuroria Themelore në Gjilan në DP ka zgjidhur 299 lëndë **më pak** se sa janë pranuar apo 80.34% e lëndëve që ka pranuar. Në përgjithësi në DP, PTH Gjilan ka zgjidhur 1,222 lëndë apo 34.94% të lëndëve që ka pasur në punë.

Në DKR janë zgjidhur 19 lëndë **më shumë** se sa janë pranuar apo 105.91% e lëndëve që janë pranuar. Në përgjithësi në DKR, PTH Gjilan ka zgjidhur 340 lëndë apo 51.75% e lëndëve që kanë qenë në punë.

DM ka zgjidhur 11 lëndë **më pak** se sa janë pranuar apo 85.52% e lëndëve që janë pranuar. Gjithsej ka zgjidhur 65 lëndë apo 83.33%, e të gjitha lëndëve që ka pasur në punë.

Sipas regjistrave situata me lëndë në punë dhe të zgjidhura qëndron si më poshtë:

#### Lëndë në punë dhe të zgjidhura sipas regjistrave



Grafikoni 29: Lëndë në punë dhe të zgjidhura sipas regjistrave në PTH Gjilan

Bazuar në këto të dhëna mund të konstatojmë se në PTH Gjilan, në regjistrin PP ka zgjidhur 48 lëndë *më pak* se sa janë pranuar gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023 apo 95.67% e lëndëve të pranuara, ndërsa në total janë zgjidhur 1,061 lëndë apo 90.14%, e të gjitha lëndëve në punë.


Në regjistrin PPN janë zgjidhur 6 lëndë *më pak* se sa janë pranuar apo 98.77% e lëndëve të pranuara, kurse në total janë zgjidhur 483 lëndë apo 62.80% e të gjitha lëndëve në punë.

Në regjistrin PPM janë zgjidhur 8 lëndë *më pak* se sa janë pranuar apo 85.71% e lëndëve të pranuara, kurse në total janë zgjidhur 48 lëndë apo 82.75% e të gjitha lëndëve në punë.

Në regjistrin PPP janë zgjidhur 229 lëndë *më pak* se sa janë pranuar apo 10.19% e lëndëve të pranuara, kurse gjithsej janë zgjidhur 68 lëndë apo 1.17% e të gjitha lëndëve në punë.

Në regjistrin NJN janë zgjidhur 9 lëndë *aq* se sa janë pranuar 100%, lëndëve të pranuara, kurse gjithsejtë janë zgjidhur 9 lëndë apo 0.40% e të gjitha lëndëve në punë.

#### Lëndët e zgjidhura me procedura alternative:




Grafikoni 30: Lëndë të zgjidhura me procedura alternative në PTH Gjilan

## 6.6 Prokuroria Themelore në Prizren

Prokuroria Themelore në Prizren gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023 ka pasur në punë gjithsej 12,182 lëndë-kallëzime penale, nga të cilat sipas departamenteve gjendja paraqitet si më poshtë:

## Lëndë në punë dhe të zgjidhura sipas departamenteve



Grafikoni 31: Lëndë në punë dhe të zgjidhura sipas departamenteve në PTH Prizren


Këto të dhëna tregojnë se Prokuroria Themelore në Prizren në DP ka zgjidhur 386 lëndë *më pak* se sa janë pranuar apo 80.09% e lëndëve të pranuara. Në përgjithësi në DP, PTH Prizren ka zgjidhur 1,553 lëndë apo 14.45% të lëndëve që ka pasur në punë.

Në DKR janë zgjidhur 18 lëndë *më shumë* se sa janë pranuar apo 105.78% e lëndëve të pranuara. Në përgjithësi në DKR, PTH Prizren janë zgjidhur 329 lëndë, apo 27.53% e lëndëve që kanë qenë në punë.

DM ka zgjidhur 6 lëndë *më shumë* se sa janë pranuar apo 104.19% e lëndëve të pranuara. Në përgjithësi në DM, PTH Prizren janë zgjidhur 149 lëndë, apo 61.06% e lëndëve që kanë qenë në punë.

Sipas regjistrave situata me lëndë në punë dhe të zgjidhura qëndron si më poshtë:

## Lëndë në punë dhe të zgjidhura sipas regjistrave



Grafikoni 32: Lëndë në punë dhe të zgjidhura sipas regjistrave në PTH Prizren

Bazuar në këto të dhëna mund të konstatojmë se në PTH Prizren, në regjistrin PP janë zgjidhur 127 lëndë **më pak** se sa janë pranuar gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023 apo 88.96% e lëndëve të pranuara, ndërsa në total janë zgjidhur 1,024 lëndë apo 61.64% e të gjitha lëndëve në punë.


Në regjistrin PPN janë zgjidhur 25 lëndë **më pak** se sa janë pranuar në punë gjatë periudhës raportuese apo 96.80%. Llogaritur me numrin e përgjithshëm të lëndëve që kanë qenë në punë janë kryer 757 lëndë apo 45.08% e të gjitha lëndëve në punë.

Në regjistrin PPM janë kryer 5 lëndë **më pak** se sa janë pranuar apo 94.68% e lëndëve të pranuara në punë, ndërsa llogaritur me totalin e lëndëve që kanë qenë në punë janë zgjidhur 89 lëndë apo 58.55% e të gjitha lëndëve në punë.

Në regjistrin PPP janë kryer 209 lëndë *më pak* apo 38.88% e lëndëve të pranuara ose 133 lëndë apo 1.53% e të gjitha lëndëve në punë, ndërsa në total janë zgjedhur 133 lëndë apo 1.53% e të gjitha lëndëve në punë.

Në regjistrin NJN janë kryer 4 lëndë më shumë apo 116.66% e lëndëve të pranuara, ndërsa në total janë zgjidhur 28 lëndë apo 71.79% e të gjitha lëndëve në punë.

#### Lëndët e zgjidhura me procedura alternative:




Grafikoni 33: Lëndë të zgjidhura me procedura alternative në PTH Prizren

#### 6.7 Prokuroria Themelore në Pejë

Prokuroria Themelore në Pejë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023 ka pasur në punë gjithsej 5,610 lëndë-kallëzime penale, nga të cilat sipas departamenteve gjendja paraqitet si më poshtë:

### Lëndë në punë dhe të zgjidhura sipas departamenteve



Grafikoni 34: Lëndë në punë dhe të zgjidhura sipas departamenteve në PTH Pejë


Këto të dhëna tregojnë se Prokuroria Themelore në Pejë në DP ka zgjidhur 666 lëndë *më pak* se sa janë pranuar apo 65.59% e lëndëve të pranuara. Në përgjithësi në DP, PTH Pejë ka kryer 1,270 lëndë apo 26.75% të lëndëve që ka pasur në punë.

Në DKR janë zgjidhur 38 lëndë *më shumë* se sa janë pranuar apo 116.45% e lëndëve të pranuara. Në përgjithësi në DKR, PTH Pejë ka kryer 269 lëndë, apo 40,88% e lëndëve që kanë qenë në punë.

DM ka kryer 22 lëndë *më pak* se sa ka pranuar apo 86.74% e lëndëve të pranuara. Në total janë zgjidhur 144 lëndë apo 69.90% e të gjitha lëndëve që ka pasur në punë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023.

Sipas regjistrave situata me lëndë në punë dhe të zgjidhura qëndron si më poshtë:

#### Lëndë në punë dhe të zgjidhura sipas regjistrave



Grafikoni 35: Lëndë në punë dhe të zgjidhura sipas regjistrave në PTH Pejë

Bazuar në këto të dhëna mund të konstatojmë se në PTH Pejë, në regjistrin PP janë zgjidhur 24 lëndë *më pak* se sa janë pranuar apo 98.04% e lëndëve të pranuara, apo në përgjithësi janë zgjidhur 1,205 lëndë ose 55,19% e të gjitha lëndëve në punë.


Në regjistrin PPN janë zgjidhur 341 lëndë *më pak* se sa janë pranuar apo 50.07% e lëndëve që janë pranuar në punë. Llogaritur me numrin e përgjithshëm të lëndëve që kanë qenë në punë janë zgjidhur 342 lëndë apo 19.21% e të gjitha lëndëve në punë.

Në regjistrin PPM janë zgjidhur 13 lëndë *më pak* se sa janë pranuar, apo 87.61% e lëndëve që janë pranuar në punë, ndërsa llogaritur me totalin e lëndëve që kanë qenë në punë janë zgjidhur 92 apo 71.31% e të gjitha lëndëve në punë.

Në regjistrin PPP janë zgjidhur 277 lëndë *më pak* se sa janë pranuar, ose 9.47% e lëndëve që janë pranuar, kurse në total janë zgjidhur 29 ose 1.93% e të gjitha lëndëve në punë.

Në regjistrin NJN janë zgjidhur 5 lëndë *më shumë* apo 150% e lëndëve të pranuara, ndërsa në total janë zgjidhur 15 lëndë apo 65.21% e të gjitha lëndëve në punë.

#### Lëndët e zgjidhura me procedura alternative:




Grafikoni 36: Lëndë të zgjidhura me procedura alternative në PTH Pejë

## 6.8 Prokuroria Themelore në Ferizaj

Prokuroria Themelore në Ferizaj gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023 ka pasur në punë gjithsej 11,532 lëndë-kallëzime penale, nga të cilat sipas departamenteve gjendja paraqitet si më poshtë:

#### Lëndë në punë dhe të zgjidhura sipas departamenteve




Grafikoni 37: Lëndë në punë dhe të zgjidhura sipas departamenteve në PTH Ferizaj

Këto të dhëna tregojnë se Prokuroria Themelore në Ferizaj në DP ka zgjidhur 367 lëndë *më pak* se sa janë pranuar apo 74.75% e lëndëve që janë pranuar. Në përgjithësi në DP, PTH Ferizaj ka kryer 1,087 lëndë apo 10.76% të lëndëve që ka pasur në punë.

Në DKR janë zgjidhur 36 lëndë *më shumë* se sa janë pranuar apo 119.56% e lëndëve që janë pranuar. Në përgjithësi në DKR, PTH Ferizaj ka kryer 220 lëndë, apo 18.01% të lëndëve që kanë qenë në punë.

DM ka kryer 32 lëndë *më pak* se sa ka pranuar në punë apo 72.41%, e lëndëve që ka pranuar, ndërsa në krahasim me numrin e lëndëve që ka pasur në punë janë zgjidhur 39.62%.

### Lëndë në punë dhe të zgjidhura sipas regjistrave



Grafikoni 38: Lëndë në punë dhe të zgjidhura sipas regjistrave në PTH Ferizaj

Bazuar në këto të dhëna mund të konstatojmë se në PTH Ferizaj, në regjistrin PP janë zgjidhur 66 lëndë *më pak* se sa janë pranuar apo 92.65% e lëndëve që janë pranuar në punë, apo në përgjithësi janë zgjidhur 833 lëndë ose 63.10% e të gjitha lëndëve në punë.


Në regjistrin PPN janë zgjidhur 35 lëndë *më pak* se sa janë pranuar apo 90.95% e lëndëve që janë pranuar në punë. Llogaritur me numrin e përgjithshëm të lëndëve që kanë qenë në punë janë zgjidhur 324 ose 17.89% e të gjitha lëndëve në punë.

Në regjistrin PPM janë zgjidhur 18 lëndë *më pak* se sa janë pranuar apo 81.63% e lëndëve që janë pranuar në punë, ndërsa llogaritur me totalin e lëndëve që kanë qenë në punë, janë zgjidhur 80 lëndë apo 46.78% e të gjitha lëndëve në punë.

Në regjistrin PPP janë zgjidhur 255 lëndë *më pak* se sa janë pranuar, apo 35.60% e lëndëve që janë pranuar në punë, ndërsa në total janë zgjidhur 141 lëndë ose 1.71% e të gjitha lëndëve në punë.

Në regjistrin NJN është zgjidhur 11 lëndë *më shumë* se sa janë pranuar, apo 650% e lëndëve që janë pranuar në punë, ndërsa në total janë zgjidhur 13 lëndë ose 65% e të gjitha lëndëve në punë.

### Lëndët e zgjidhura me procedura alternative:




Grafikoni 39: Lëndë të zgjidhura me procedura alternative në PTH Ferizaj

## 6.9 Prokuroria Themelore në Gjakovë

Prokuroria Themelore në Gjakovë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023 ka pasur në punë gjithsej 5,901 lëndë-kallëzime penale, nga të cilat sipas departamenteve gjendja paraqitet si më poshtë:

### Lëndë në punë dhe të zgjidhura sipas departamenteve




Grafikoni 40: Lëndë në punë dhe të zgjidhura sipas departamenteve në PTH Gjakovë

Nga këto të dhëna shihet se Prokuroria Themelore në Gjakovë në DP ka zgjidhur 666 lëndë **më pak** se sa janë pranuar apo 52.36% e lëndëve që janë pranuar. Në përgjithësi DP në PTH Gjakovë ka zgjidhur 732 lëndë apo 15.25% të lëndëve që ka pasur në punë.

Në DKR janë zgjidhur 56 lëndë **më pak** se sa janë pranuar apo 14.30% e lëndëve që janë pranuar. Në përgjithësi DKR në PTH Gjakovë ka zgjidhur 200 lëndë, apo 26.91% e lëndëve që kanë qenë në punë.

DM ka zgjidhur 44 lëndë **më pak** se sa janë pranuar apo 60.71%, e lëndëve që janë pranuar në punë kurse në përgjithësi janë zgjidhur 68 lëndë apo 18.94% e lëndëve që ka pasur në punë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023.

#### Lëndë në punë dhe të zgjidhura sipas regjistrave



Grafikoni 41: Lëndë në punë dhe të zgjidhura sipas regjistrave në PTH Gjakovë

Bazuar në këto të dhëna mund të konstatojmë se në PTH Gjakovë, në regjistrin PP janë zgjidhur 86 lëndë *më pak* se sa janë pranuar ose 89.94% e lëndëve të pranuara. Llogaritur me numrin e përgjithshëm të lëndëve që kanë qenë në punë janë zgjidhur 769 ose 39.13% e të gjitha lëndëve në punë.


Në regjistrin PPN janë zgjidhur 376 lëndë *më pak* se sa janë pranuar apo 26,70% e lëndëve që janë pranuar. Llogaritur me numrin e përgjithshëm të lëndëve që kanë qenë në punë janë zgjidhur 137 lëndë apo 7.65% e të gjitha lëndëve në punë.

Në regjistrin PPM janë zgjidhur 32 lëndë *më pak* se sa janë pranuar apo 67.34% e lëndëve të pranuara në punë, ndërsa llogaritur me totalin e lëndëve që kanë qenë në punë, janë zgjidhur 66 ose 25.19% e të gjitha lëndëve në punë.

Në regjistrin PPP janë zgjidhur 277 lëndë *më pak* se sa janë pranuar apo 3.81% e lëndëve të pranuara, apo në total janë zgjidhur 11 lëndë ose 0.59% e të gjitha lëndëve në punë.

Në regjistrin NJN janë zgjidhur 5 lëndë *më shumë* se sa janë pranuar apo 141% e lëndëve të pranuara në punë, ndërsa në total janë zgjidhur 17 lëndë ose 60,71% e të gjitha lëndëve në punë.

#### Lëndët e zgjidhura me procedura alternative:




Grafikoni 42: Lëndë të zgjidhura me procedura alternative në PTH Gjakovë

#### 6.10 Prokuroria Themelore në Mitrovicë

Prokuroria Themelore në Mitrovicë gjatë gjashtëmujorit të parë 2023 ka pasur në punë gjithsej 9,885 lëndë-kallëzime penale, nga të cilat sipas departamenteve gjendja paraqitet si më poshtë:

## Lëndë në punë dhe të zgjidhura sipas departamenteve




Grafikoni 43: Lëndë në punë dhe të zgjidhura sipas departamenteve në PTH Mitrovicë

Këto të dhëna tregojnë se Prokuroria Themelore në Mitrovicë në DP ka zgjidhur 950 lëndë *më pak* se sa janë pranuar apo 36.87% e lëndëve të pranuara. Në përgjithësi në DP, PTH Mitrovicë ka zgjidhur 555 lëndë apo 7.84% të lëndëve që ka pasur në punë.

Në DKR janë zgjidhur 54 lëndë *më shumë* se sa janë pranuar apo 120.84% e lëndëve që janë pranuar. Në përgjithësi në DKR, PTH Mitrovicë ka zgjidhur 313 lëndë, apo 12.23% e lëndëve që kanë qenë në punë.

DM ka zgjidhur 40 lëndë *më pak* se sa janë pranuar apo 50% e lëndëve që janë pranuar në punë. Në total DM ka zgjidhur 40 lëndë apo 15.62% e lëndëve që kanë qenë në punë.

## Lëndë në punë dhe të zgjidhura sipas regjistrave



Grafikoni 44: Lëndë në punë dhe të zgjidhura sipas regjistrave në PTH Mitrovicë

Bazuar në këto të dhëna mund të konstatojmë se në PTH Mitrovicë, në regjistrin PP janë zgjidhur 371 lëndë *më pak* se sa janë pranuar apo 65.19% e lëndëve të pranuara. Në total janë zgjidhur 695 lëndë apo 24.81% e të gjitha lëndëve në punë.


Në regjistrin PPN janë zgjidhur 233 lëndë *më pak* apo 39.16% e lëndëve të pranuara në punë. Llogaritur me numrin e përgjithshëm të lëndëve që kanë qenë në punë janë zgjidhur 150 lëndë apo 5.71% e të gjitha lëndëve në punë.

Në regjistrin PPM janë zgjidhur 18 lëndë *më pak* se sa janë pranuar apo 68.96% e lëndëve të pranuara në punë, ndërsa llogaritur me totalin e lëndëve që kanë qenë në punë, janë zgjidhur 40 lëndë apo 23.39% e të gjitha lëndëve në punë.

Në regjistrin PPP janë zgjidhur 312 lëndë *më pak* apo 3.59% e lëndëve të pranuara, ndërsa gjithsej janë zgjidhur 22 lëndë apo 0.51% e të gjitha lëndëve në punë.

Në regjistrin NJN janë zgjidhur 2 lëndë *më pak* se sa janë pranuar 33.33% e lëndëve të pranuara, apo gjithsej janë zgjidhur 1 lëndë apo 3.44% e të gjitha lëndëve në punë.

### Lëndët e zgjidhura me procedura alternative:



Grafikoni 45: Lëndë të zgjidhura me procedura alternative në PTH Mitrovicë

## 7. Kallëzimet penale sipas departamenteve në kuadër të prokurorive themelore

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, PTH-të në të gjitha departamentet kanë pasur në punë 108,182 kallëzime-lëndë penale (PP, PPM, NJN, PPN, PPP) përfshirë ato të trashëgura nga vitet paraprake.


Në vijim pasqyrohen kallëzimet-lëndët penale të pranuara në punë, të zgjidhura dhe të pazgjidhura:

- Të trashëgura në fillim të periudhës reportuese ishin 86,853 ose 80.28%, kallëzime-lëndë penale;
- Të pranuara në punë 21,329 ose 19.71%, kallëzime-lëndë penale;
- Të zgjidhura apo proceduara në organet kompetente 15,252 ose 14.09% kallëzime-lëndë penale apo 6,077 më pak se që janë pranuar;

- Të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese 92,930 ose 85.90% të kallëzimeve-lëndëve penale (nga numri total i kallëzimeve-lëndëve në punë).

Nga kjo rezulton se prokuroritë themelore kanë zgjidhur 6,077 lëndë më pak se sa janë pranuar ose 71.50% e lëndëve të pranuara, ndërsa sa i përket zgjidhjes së rasteve **të kryesve madhorë (PP)** prokuroritë kanë zgjidhur 1,808 kallëzime-lëndë penale apo 15.84% më pak se që kanë pranuar.

Në vijim pasqyrohet numri i përgjithshëm i kallëzimeve-lëndëve penale në prokuroritë themelore:




Grafikoni 46: Kallëzimet-lëndët penale në DKR, DM dhe DP të të gjitha prokurorive themelore (PP, PPM, NJN, PPN, PPP)

Kallëzimet-lëndët penale në punë (108,182) u përkasin si më poshtë:


- Departamenteve të krimeve të rënda 11,617 ose 10.73%;
- Departamenteve për të mitur 2,203 ose 2.03% dhe
- Departamenteve të përgjithshme 94,362 ose 87.22%.

Struktura e kallëzimeve - lëndëve penale të pazgjidhura të pranuara në punë të zgjidhura dhe të pazgjidhura në fund të gjashtëmujorit të parë 2023, sipas departamenteve të PTH-ve duket si në vijim:



Grafikoni 47: Kallëzimet-lëndët penale të pazgjidhura dhe të pranuara në punë, sipas departamenteve

Në grafikonin në vijim, pasqyrohet diferenca në numrin e lëndëve të pranuara në tri departamentet e PTH-ve përgjatë periudhës raportuese mes viteve 2022 dhe 2023.




Grafikoni 48: Diferenca e kallëzimeve-lëndëve penale të pranuara në tri departamentet gjatë gjashtëmujorit të viteve 2022 dhe 2023.

Në DKR, numri i kallëzimeve penale të pranuara në punë gjatë gjashtëmujorit të parë 2023, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022, është zvogëluar për 813 kallëzime penale ose 24.68%.

Në DM, numri i kallëzimeve penale të pranuara në punë gjatë gjashtëmujorit të parë 2023, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022, është zvogëluar për 4 kallëzime penale ose 0.33%.

Në DP, numri i kallëzimeve penale të pranuara në punë gjatë gjashtëmujorit të parë 2023, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022, është zvogëluar për 243 kallëzime penale ose 1.35%.

Diferenca në numrin e lëndëve të zgjidhura në tri departamentet e PTH-ve përgjatë gjashtëmujorit të parë mes viteve 2022 dhe 2023, paraqitet si më poshtë:



Grafikoni 49: Diferenca e lëndëve të zgjidhura në tri departamentet përgjatë gjashtëmujorit të parë mes viteve 2022 dhe 2023.


Në DKR, numri i kallëzimeve-lëndëve penale të zgjidhura gjatë gjashtëmujorit të parë 2023, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022, është rritur për 24 ose 0.84%;

Në DM, numri i kallëzimeve-lëndëve penale të zgjidhura gjatë gjashtëmujorit të parë 2023, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022 është zvogëluar për 235 ose 20.63%, dhe

Në DP, numri i kallëzimeve-lëndëve penale të zgjidhura gjatë gjashtëmujorit të parë 2023, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022 është zvogëluar për 1,884 ose 14.09%.


## 7.1. Departamentet e krimeve të rënda të prokurorive themelore

Gjatë periudhës raportuese, DKR-të e PTH-ve kanë pasur në punë gjithsejtë 11,617 kallëzime-lëndë penale, siç pasqyrohet në grafikonin në vijim për të gjitha regjistrat:




Grafikoni 50: Kallëzimet-lëndët penale në DKR të të gjitha prokurorive themelore (PP, NJN, PPN, PPP)

Në vijim pasqyrohet numri i kallëzimeve-lëndëve penale të pazgjidhura në fillim të vitit 2023, dhe numri i atyre të pranuara në punë gjatë periudhës reportuese për secilën DKR të PTH-ve.




Grafikoni 51: Kallëzimet-lëndët penale të pazgjidhura në fillim të periudhës reportuese dhe lëndët e pranuara gjatë gjashtëmujorit të parë 2023.

Në grafikonin në vijim pasqyrohen të gjitha llojet e kallëzimeve-lëndëve penale në punë, të zgjidhura dhe ato të mbeturë në fund të periudhës reportuese për secilën DKR të PTH-ve.



Grafikoni 52: Kallëzimet-lëndët penale në punë, të zgjidhura dhe të pazgjidhura për secilën prokurori gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023


Në vazhdim pasqyrohet numri i kallëzimeve-lëndëve penale të pranuara dhe të zgjidhura gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2022, për secilën DKR të PTH-ve.



Grafikoni 53: Kallëzimet-lëndët penale të pranuara dhe të zgjidhura në gjashtëmujorin e parë 2023

Sipas grafikonit më lartë, rezulton që 37.01% të kallëzimeve-lëndëve të pranuara në punë i përkasin DKR në PTH të Prishtinës, kurse 62.99% u përkasin DKR të PTH-ve të tjera.

Në grafikonin në vijim pasqyrohen kallëzimet penale për kryesit madhor (PP) të trashëgura nga viti paraprak, të pranuara, në punë, të zgjidhura dhe ato të mbeturë në fund të periudhës raportuese për secilën DKR të PTH-ve, sipas prokurorive.



Grafikoni 54: Kallëzimet penale për kryesit madhor (PP) të trashëgura nga viti paraprak, të pranuara, në punë, të zgjidhura dhe ato të mbeturë në fund të periudhës raportuese për secilën DKR të PTH-ve.

**DKR-të e PTH-ve në zgjidhjen e kallëzimeve-lëndëve penale mbi dhe nën normën e përcaktuar me Udhëzim Administrativ, për çdo prokuror për periudhën raportuese, është si në vijim:**

- DKR i PTH-së në Gjakovë ka zgjidhur - 57.50 kallëzime-lëndë penale ose 21.5 kallëzime-lëndë penale mbi normën gjashtëmujore;
- DKR i PTH-së në Prishtinë - 52.50 kallëzime-lëndë penale ose 16.5 kallëzime-lëndë penale mbi normën gjashtëmujore;
- DKR i PTH-së në Mitrovicë - 45.8 kallëzime-lëndë penale ose 9.8 kallëzime-lëndë penale mbi normën gjashtëmujore;

**DKR-të e PTH-ve që kanë zgjidhur e kallëzimet penale për një prokuror nën normën e përcaktuar me udhëzim, për periudhën raportuese është si në vijim:**

- DKR i PTH-së në Gjilan - 35.25 kallëzime-lëndë penale ose 0.75 kallëzime -lëndë penale nën normën gjashtëmujore,
- DKR i PTH-së në Pejë - 24.00 kallëzime-lëndë penale ose 12 kallëzime-lëndë penale nën normën gjashtëmujore;
- DKR i PTH-së në Prizren - 23.80 kallëzime-lëndë penale ose 12.2 kallëzime-lëndë penale nën normën gjashtëmujore;
- DKR i PTH-së në Ferizaj - 21.75 kallëzime-lëndë penale ose 14.25 kallëzime-lëndë penale nën normën gjashtëmujore;

Kallëzimet-lëndët penale të pazgjidhura në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022, në DKR të PTH-ve është zvogëluar për 346 kallëzime-lëndë penale ose për 14.88%.

#### **7.1.1. Mënyra e zgjidhjes së kallëzimeve penale të kryerësve madhorë të veprave penale (PP) nga DKR-të**

Nga kallëzimet penale të cilat kanë qenë në punë (2,454 me 6,104 persona), prokurorët e DKR-ve i kanë përfunduar 1,123 kallëzime penale ose 45.76% me 1,862 persona ose 30.50% të personave.

Kallëzimet penale që kanë qenë në punë, prokurorët i kanë zgjidhur në këto mënyra:

- Me aktakuzë të drejtpërdrejtë i kanë përfunduar 2 ose 0.11% të personave;
- Me hedhje të kallëzimit penal janë zgjidhur 332 ose 17.83% të personave.

Procedura hetimore është hapur ndaj 1,621 personave. Rastet e 589 ose 36.33% të personave kanë qenë hetime të pazgjidhura nga periudha paraprake, kurse ndaj 1,032 ose 63.66% të personave vendimi për hetim është marrë gjatë periudhës raportuese:

Pas përfundimit të hetimit:

- Aktakuza është ngritur ndaj 744 ose 39.95%, personave;
- Hetimet janë pushuar ndaj 285 ose 15.30%, personave;
- Cedim i lëndëve në kompetencë 499 persona ose 26.79%.

Në fund të gjashtëmujorit të vitit 2023 kanë mbetur të papërfunduara hetimet ndaj 592 personave. Gjatë periudhës raportuese, prokurorët e DKR-ve kanë parashtruar 261 kërkesa për caktim të paraburgimit, nga të cilat gjykatat kanë aprovuar 229 ose 87.73% të tyre.

### 7.1.2 Vendimet gjyqësore përkitazi me aktet akuzuese të prokurorëve

Gjatë kësaj periudhe, DKR-të e gjykatave themelore, duke vendosur sipas akteve akuzuese të prokurorëve të DKR-ve të PTH-ve kanë marrë 850 vendime gjyqësore, si në vijim, duke:

- Shpallur fajtor dhe dënuar me aktgjykim fajësues 735 persona 86.74%;
- Shqiptuar masa të trajtimit të detyrueshëm 0 persona ose 0%;
- Hedhur aktakuzën ndaj 13 personave ose 1.52%;
- Refuzuar aktin akuzues kundër 32 personave ose 3.76% dhe
- Liruar nga aktet akuzuese 70 persona ose 8.23%.

Prokurorët e DKR-ve, ndaj vendimeve të gjykatave kanë parashtruar 171 ankesa përkitazi me vendimet gjyqësore, nga të cilat 125 ose 73.09% të ankesave janë parashtruar vetëm për shkak të vendimit mbi dënimin.


## 7.2. Departamentet për të mitur të prokurorive themelore

Gjatë periudhës raportuese, DM të PTH-ve kanë pasur në punë gjithsej 2,203 kallëzime penale, prej tyre:

- Të trashëguara në fillim të periudhës raportuese ishin 1,000 ose 45.39% kallëzime-lëndë penale;
- Të pranuara në punë janë 1,203 ose 54.60% kallëzime-lëndë;
- Të zgjidhura 904 ose 41.03% kallëzime-lëndë dhe
- Të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese janë 1,299 ose 58.96% kallëzime-lëndë.


Nëse marrim përbazë vetëm numrin e lëndëve të pranuara në këtë periudhë, DM-të e PTH-ve kanë arritur që t'i zgjidhin 299 kallëzime-lëndë penale **më pak** sesa kanë pranuar ose 24.85%.

Në vijim pasqyrohet numri i përgjithshëm i kallëzimeve-lëndëve penale në DM të të gjitha prokurorive themelore në të gjithë regjistrat:




Grafikoni 55: Kallëzimet-lëndët penale në DM të të gjitha prokurorive themelore (PPM, PPN/M)

Në grafikonet në vijim pasqyrohet numri i kallëzimeve penale të pazgjidhura në fillim të vitit 2023 dhe atyre të pranuara në punë në DM të PTH-ve gjatë periudhës raportuese.




Grafikoni 56: Kallëzimet-lëndët penale të pazgjidhura në fillim të vitit 2023 dhe të pranuara gjatë gjashtëmujorit të parë 2023 në DM të PH-ve

Në grafikonin në vijim pasqyrohen të gjitha llojet e kallëzimeve-lëndëve penale në punë, të zgjidhura dhe ato të mbeturat në fund të periudhës raportuese gjatë periudhës raportuese për secilën DM të PTH-ve.




Grafikoni 57: Kallëzimet – lëndët penale të pranuara, të zgjidhura dhe të pazgjidhura në fund të periudhës në DM të PTH-ve.

Në grafikonin në vijim pasqyrohen kallëzimet penale për kryesit e mitur (PPM) të trashëguara nga viti paraprak, të pranuara, në punë, të zgjidhura dhe ato të mbeturat në fund të periudhës raportuese për secilën DM të PTH-ve.



Grafikoni 58: Kallëzimet penale për kryerësit e mitur (PPM) të trashëguara nga viti paraprak, të pranuara, në punë, të zgjidhura dhe ato të mbeturat në fund të periudhës raportuese për secilën DM të PTH-ve.

Grafikoni në vazhdim tregon numrin e kallëzimeve penale të pranuara dhe të zgjidhura për gjashtëmujorin e parë 2023 për secilin DM të PTH-ve.



Grafikoni 59: Kallëzimet – lëndët penale të pranuara dhe të përfunduara në gjashtëmujorin e parë 2023, për secilën DM të PTH-ve.

Numri i kallëzimeve-lëndëve penale të pazgjidhura në fund të gjashtëmujorit të parë 2023, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022, është rritur për 185 ose 16.60%.

**DM-të e PTH-ve që kanë zgjidhur kallëzimet penale për një prokuror mbi normën e përcaktuar me udhëzim, për periudhën raportuese është si në vijim:**

- DM i PTH-së në Ferizaj – 81.00 kallëzime penale ose 21 kallëzime penale mbi normën gjashtëmujore;
- DM i PTH-së në Prishtinë – 66.44 kallëzime penale ose 6.44 kallëzime penale mbi normën gjashtëmujore;
- DM i PTH-së në Gjakovë – 66.00 kallëzime penale ose 6.00 kallëzime penale mbi normën gjashtëmujore;

**DM-të e PTH-ve që kanë zgjidhur kallëzimet penale për një prokuror nën normën e përcaktuar me udhëzim, për periudhën raportuese është si në vijim:**

- DM i PTH Gjilan – 50.00 kallëzime penale ose 10.00 kallëzime penale nën normën vjetore gjashtëmujore;
- DM i PTH Pejë – 49.00 kallëzime-lëndë penale ose 11.00 kallëzime penale nën normën gjashtëmujore;
- DM i PTH-së në Prizren – 48.50 kallëzime penale ose 10.50 kallëzime nën normën gjashtëmujore;
- DM i PTH-së në Pejë – 49.5 kallëzime penale ose 10.5 kallëzime penale nën normën gjashtëmujore;

### 7.2.1 Mënyra e zgjidhjes së kallëzimeve penale të kryesve të mitur të veprave penale (PPM) në DM

Nga 1,624 kallëzime penale për të mitur me 2,578 persona, të cilat kanë qenë në punë gjatë kësaj periudhe, prokurorët e DM të PTH-ve kanë zgjidhur 696 kallëzime penale me 1,067 persona të mitur:

- Për 231 ose 21.64%, të personave të mitur, nuk ka filluar procedura përgatitore (parimi i oportunitetit);
- Për 57 ose 5.34%, të personave të mitur është pushuar procedura përgatitore;
- Për 127 ose 11.90% të personave të mitur është hedhur kallëzimi penal;
- Për 115 ose 10.77% të personave të mitur është propozuar të shqiptohet masa e diversitetit nga ana e prokurorit;
- Për 74 ose 6.93%, të personave të mitur është propozuar të shqiptohet masa disiplinore;
- Për 283 ose 26.52%, të personave të mitur është propozuar të shqiptohet masa e mbikëqyrjes së shtuar;
- Për 90 ose 8.43%, të personave të mitur është propozuar të shqiptohet masa institucionale;
- Për 4 ose 0.37%, të personave të mitur është propozuar të shqiptohet burgimi për të mitur;
- Për 5 ose 0.46%, të personave të mitur është propozuar të shqiptohet masa e trajtimit të detyrueshëm;
- Për 30 ose 2.81% të personave të mitur është propozuar në procedurë të ndërmjetësimit;
- Për 5 ose 0.46% të personave të mitur është propozuar urdhri për punë në dobi të përgjithshme dhe
- Për 39 ose 3.63%, të personave të mitur, rastet janë zgjidhur në mënyrë tjetër.

### 7.2.2 Vendimet gjyqësore përkitazi me propozimet e prokurorëve për të mitur

DM-të e gjykatave themelore, duke vepruar sipas propozimeve të prokurorëve të DM-ve të PTH-ve, ndaj 412 personave kanë marrë këto vendime gjyqësore:

- Aktgjykime për shqiptimin e dënimit ndaj të miturve janë marrë ndaj 34 ose 8.25% të personave;
- Aktvendime për shqiptimin e masës edukative janë marrë ndaj 337 ose 81.79%, të personave, dhe
- Aktvendime për pushimin e procedurës për të mitur janë marrë ndaj 41 ose 9.95%, të personave.

### 7.3. Departamentet e përgjithshme të prokurorive themelore


Gjatë periudhës raportuese DP të PTH-ve kanë pasur në punë gjithsej 94,362 kallëzime-lëndë penale, prej tyre:

- Të trashëguara në fillim të periudhës raportuese ishin 76,716 ose 81.29% kallëzime-lëndë;
- Të pranuara në punë janë 17,646 ose 18.70% kallëzime-lëndë;
- Të zgjidhura 11,484 ose 12.17% kallëzime-lëndë penale dhe
- Të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese 82,878 ose 87.82% të kallëzimeve-lëndëve penale sa ishin në punë.

Bazuar në numrin e kallëzimeve-lëndëve të pranuara në këtë periudhë, DP të PTH-ve kanë arritur që t'i zgjidhin 6,162 ose 34.93% më pak kallëzime-lëndë penale sesa kanë pranuar në punë ose 12.17% e lëndëve në punë.


Numri i kallëzimeve-lëndëve penale të pazgjidhura në fund të gjashtëmujorit të parë 2023, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022, ka shënuar rritje për 7,837 kallëzime-lëndë penale ose 10.44%.

Më poshtë pasqyrohet numri i përgjithshëm i kallëzimeve-lëndëve penale në DP të gjitha prokurorive themelore për të gjithë regjistrat:




Grafikoni 60: Kallëzimet – lëndët penale në DP të gjitha prokurorive themelore (PP, PPP, PPN)

Në vijim pasqyrohet numri i kallëzimeve-lëndëve penale të pazgjidhura në fillim të vitit 2023 dhe të pranuara në punë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023 në DP të gjitha prokurorive themelore:




Grafikoni 61: Kallëzimet -lëndët penale të pazgjidhura në fillim të vitit 2022 dhe të pranuara në DP të PTH-ve

Në grafikonin në vijim pasqyrohen të gjitha llojet e kallëzimeve-lëndëve penale në punë, të zgjidhura dhe ato të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese, për secilin DP të PTH-ve.




Grafikoni 62: Kallëzimet – lëndët penale të pranuara, të zgjidhura dhe të pazgjidhura në DP të PTH-ve

Në grafikonin në vijim pasqyrohen kallëzimet penale në punë, të zgjidhura dhe ato të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese, për kryesit madhorë (PP) për secilën DP të PTH-ve.



Grafikoni 63: Kallëzimet penale për kryesit rritur (PP) të trashëguara, të pranuara, në punë, të zgjidhura dhe ato të mbeturat në fund të periudhës raportuese për secilën DP të PTH-ve.

Grafikoni në vazhdim tregon numrin e kallëzimeve penale të pranuara dhe të zgjidhura gjatë gjashtëmujorit të parë në vitin 2023, për secilën DP të PTH-ve.



Grafikoni 64: Kallëzimet-lëndët penale të pranuara dhe të zgjidhura në gjashtëmujorin e parë 2023, për DP të PTH-ve

Siq shihet në grafikonin më lartë, DP i PTH në Prishtinë ka pranuar 44.72% të numrit të përgjithshëm të kallëzimeve-lëndëve penale, kurse të gjitha DP të PTH-ve të tjera kanë pranuar 55.28% të kallëzimeve-lëndëve penale.

Po ashtu edhe sa i përket lëndëve të zgjidhura, PTH në Prishtinë ka arritur t'i zgjedhë 44.10% të kallëzimeve penale, ndërsa PTH-të e tjera 55.90%.

**DP-të e PTH-ve që kanë zgjidhur kallëzimet-lëndët penale për një prokuror, mbi normën siç është përcaktuar me udhëzim për periudhën raportuese, është si në vijim:**

- DP i PTH-së në Pejë – 140.63 kallëzime penale për çdo prokuror ose 2.63 kallëzime-lëndë penale mbi normën;

**DP-të e PTH-ve që kanë zgjidhur kallëzimet-lëndët penale për një prokuror, nën normën siç është përcaktuar me udhëzim për periudhën raportuese, është si në vijim:**

- DP i PTH-së në Gjilan – 109.00 kallëzime-lëndë penale ose 48.33 kallëzime-lëndë penale nën normën;
- DP i PTH-së në Prishtinë – 108.85 kallëzime-lëndë penale ose nga 29.15 kallëzime-lëndë penale nën normën.
- DP i PTH-së në Prizren – 71.71 kallëzime-lëndë penale ose nga 66.29 kallëzime-lëndë penale nën normën;
- DP i PTH-së në Ferizaj – 61.23 kallëzime-lëndë penale ose nga 76.77 kallëzime-lëndë penale nën normën.
- DP i PTH-së në Gjakovë – 61.27 kallëzime-lëndë penale ose 76.77 kallëzime nën normën;
- DP i PTH-së në Mitrovicë – 40.50 kallëzime-lëndë penale ose 97.5 kallëzime-lëndë penale nën normën;

Kallëzimet-lëndët penale të pazgjidhura në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022, në DP të PTH-ve është rritur për 7,837 kallëzime-lëndë penale ose për 10.44%.

### **7.3.1. Mënyra e zgjidhjes së kallëzimeve penale të kryerësve madhorë të veprave penale (PP) nga DP**

Në periudhën raportuese, DP të PTH-ve kanë pasur në punë gjithsejtë 17,167 kallëzime penale me 27,558 persona me kryes të njohur nga regjistri PP.

Nga numri i lëndëve në punë 6,608 ose 38.49%, kanë qenë kallëzime penale të pazgjidhura nga vitet paraprake kurse 10,559 ose 61.50%, janë kallëzime penale të cilat janë pranuar në punë gjatë periudhës raportuese.

Nga numri i kallëzimeve penale në punë, në periudhën raportuese PTH-të kanë arritur që t'i procedojnë tek gjykatat 8,476 kallëzime penale ndaj 10,132 personave.

Kallëzimet e zgjidhura penale të 10,132 personave kanë përfunduar si në vijim:

- Me aktakuzë të drejtpërdrejt i kanë përfunduar 3,530 ose 34.84% të personave;
- Me aktakuzë me kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor kanë përfunduar 1,409 ose 13.90% të personave;
- Me hedhje të kallëzimit penal janë zgjidhur 1,555 ose 15.34% të personave dhe
- Me propozim për shqiptimin e masave për trajtim të detyrueshëm janë përfunduar rastet e 63 ose 0,62% të personave.

Pas përfundimit të hetimit:

- Aktakuza është ngrit ndaj 2,880 ose 28.42 %, të personave;
- Hetimet janë pushuar ndaj 414 ose 4.08%, të personave;
- Ceduar në kompetencë rastet e 281 ose 2.77% të personave.

Procedura hetimore është hapur ndaj 5,101 personave, rastet e 1,823 ose 35.73% të personave kanë qenë hetime të pazgjidhura nga periudha paraprake, kurse ndaj 3,278 ose 64.26% të personave aktvendimi për hetim është marrë gjatë periudhës raportuese.

Gjatë periudhës raportuese prokurorët e DP në PTH kanë parashtruar 635 kërkesa për caktim të paraburgimit, nga kërkesat e parashtruara gjykatat themelore kanë aprovuar 556 ose 8.77%, të kërkesave të parashtruara.

### 7.3.2. Vendimet gjyqësore përkitazi me aktet akuzuese të prokurorëve

Gjykatat themelore duke vepruar sipas akteve akuzuese të prokurorëve të DP-ve kanë marrë 6,029 vendime gjyqësore, si vijon;

- Shpall fajtorë dhe dënuar me aktgjykim fajësues 4,196 ose 69.59% të personave;
- Me aktgjykim me urdhër ndëshkues kanë përfunduar rastet 1,314 ose 21.79% të personave;
- Masën e trajtimit të detyrueshëm i është shqiptuar 35 ose 0.58% të personave.
- Hudhjen e aktakuzës, ndaj 331 ose 5.49% të personave;
- Refuzuar aktin akuzues kundër 87 personave ose 1.44% të personave dhe
- Liruar nga aktet akuzuese 66 ose 1.09% të personave;
- 

Prokurorët e DP-ve kanë parashtruar 374 ankesa përkitazi me vendimet gjyqësore. Prej tyre 295 ose 78.87% janë parashtruar vetëm për shkak të vendimit mbi dënimin. Gjykatat gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, kanë nxjerr 909 aktvendime për shkak të parashkrimit.

## 8. Ngarkesa e prokurorëve dhe prokurorive me lëndë

Ngarkesa e prokurorëve sipas departamenteve për secilën prokurori themelore është e paraqitur në tabelën si më poshtë:


## Raporti i punës së PSH-së për gjashtëmujorin e parë 2023

Prokuroria	Departamenti	Nr i prokurorëve	Mesatarja e lëndëve të pranuara, lëndëve në punë, të zgjidhura dhe të pazgjidhura për 1 prokuror në raport me Normën sipas Udhëzimit Administrativ								
			Norma sipas UA		Gjithsej lëndë të pranuara	Lëndë të pranuara		Gjithsej lëndë të zgjidhura	Lëndë të zgjidhura		Gjithsej lëndë të pazgjidhura
			Vjetor	Mujor		Vjetor	Mujor		Vjetor	Mujor	
Prishtinë	DKR	10	66	6	406	40.60	6.77	525	52.50	8.75	889
	DM	4.5	110	10	444	98.67	16.44	299	66.44	11.07	402
	DP	34	253	23	4,986	146.65	24.44	3,701	108.85	18.14	6319
Prizren	DKR	5	66	6	126	25.20	4.20	119	23.80	3.97	153
	DM	2	110	10	100	50.00	8.33	97	48.50	8.08	67
	DP	14	253	23	1,138	81.29	13.55	1,004	71.71	11.95	1023
Pejë	DKR	5	66	6	81	16.20	2.70	120	24.00	4.00	97
	DM	2	110	10	113	56.50	9.42	99	49.50	8.25	40
	DP	8	253	23	1,243	155.38	25.90	1,125	140.63	23.44	1133
Gjilan	DKR	4	66	6	138	34.50	5.75	141	35.25	5.88	46
	DM	1	110	10	59	59.00	9.83	50	50.00	8.33	10
	DP	9	253	23	1,044	116.00	19.33	981	109.00	18.17	215
Mitrovë	DKR	5	66	6	126	25.20	4.20	229	45.80	7.63	479
	DM	2	110	10	61	30.50	5.08	31	15.50	2.58	151
	DP	12	253	23	1,002	83.50	13.92	486	40.50	6.75	2142
Ferizaj	DKR	4	66	6	72	18.00	3.00	87	21.75	3.63	147
	DM	1	110	10	100	100.00	16.67	81	81.00	13.50	96
	DP	13	253	23	890	68.46	11.41	796	61.23	10.21	926
Gjakovë	DKR	2	66	6	100	50.00	8.33	115	57.50	9.58	167
	DM	1	110	10	100	100.00	16.67	66	66.00	11.00	208
	DP	11	253	23	834	75.82	12.64	674	61.27	10.21	1318

Tabela 4: Mesatarja e lëndëve të pranuara, lëndëve në punë, të zgjidhura dhe të pazgjidhura për 1 prokuror në raport me Normën sipas Udhëzimit Administrativ për të gjitha departamentet e PTH-ve

Nga të dhënat në këtë tabelë shihet se DKR në PTH kanë pranuar mesatarisht 29.97 kallëzime-lëndë penale për një (1) prokurorë, për çdo muaj nga 4.99 kallëzime-lëndë penale për prokuror, që do të thotë se prokurorët e DKR-ve kanë pranuar lëndë nën normën mujore nga 1.01 kallëzime-lëndë penale.


Në grafikonin më poshtë paraqitet struktura e kallëzimeve-lëndëve penale të pranuara në një muaj për një prokuror.



Grafikoni 65: Kallëzimet-lëndët penale të pranuara në një muaj për një prokuror në DKR të PTH-ve

Prokurorët e DKR-ve të PTH-ve në periudhën raportuese kanë zgjidhur mesatarisht nga 38.2 kallëzime-lëndë penale ose 6.36 kallëzime për prokuror në muaj ose 0.36 kallëzime lëndë penale mbi normën e përcaktuar me udhëzim.

Në grafikonin më poshtë pasqyrohet struktura e kallëzimeve-lëndëve penale të zgjidhura në një muaj për një prokuror.




Grafikoni 66: Kallëzimet-lëndët penale të zgjidhura gjatë një muaji për një prokuror

## Raporti i punës së PSH-së për gjashtëmujorin e parë 2023

Në periudhën raportuese, mesatarisht çdo prokuror i DM të PTH-ve ka pranuar nga 69.71 kallëzime penale apo 11.61 për muaj ose 1.61 kallëzime penale mbi normën vjetore sipas udhëzimit.

Grafikoni në vazhdim tregon mesataren për secilën PTH se sa kallëzime penale në muaj i ka pranuar për një prokuror në DM.



Grafikoni 67: Mesatarja për secilin DM të PTH për kallëzimet-lëndët penale të pranuara në muaj për një prokuror.

Në periudhën raportuese, prokurorët e DM të PTH-ve mesatarisht kanë zgjidhur nga 51.57 kallëzime penale ose 8.59 kallëzime në muaj për 1 prokuror ose 1.41 kallëzime nën normën mesatare sipas udhëzuesit.


Grafikoni në vijim tregon mesataren për secilën DM të PTH-ve se sa kallëzime penale në muaj i ka zgjidhur një prokuror.



Grafikoni 68: Mesatarja për secilin DM të PTH-ve rrëth kallëzimeve penale të zgjidhura në muaj për një prokuror

Në vitin 2023, prokurorët e DP të PTH-ve kanë pranuar mesatarisht nga 110.25 kallëzime-lëndë penale ose 18.37 lëndë për muaj për prokuror apo 4.63 kallëzime-lëndë penale nën normën vjetore.

Grafikoni në vazhdim tregon mesataren për secilën PTH, se sa kallëzime penale në muaj janë pranuar për një prokuror.



Grafikoni 69: Mesatarja se sa kallëzime-lëndë penale i ka pranuar në muaj për një prokuror në secilën DP të PTH-ve.

Gjatë periudhës raportuese, çdo prokuror i DP të PTH-ve ka zgjidhur mesatarisht nga 86.79 kallëzime penale ose 14.46 për çdo muaj për prokuror ose 8.54 kallëzime-lëndë penale nën normën mujore.

Më poshtë janë paraqitur në mënyrë grafike të dhënat për mesataren e kallëzimeve penale mujore të zgjidhura nga një prokuror për secilën DP të PTH-ve.



Grafikoni 70: Mesatarja për secilën DP të PTH-ve se sa kallëzime penale në muaj i ka zgjidhur një prokuror

## 9. Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Víktimave

Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Víktimave (ZMNV) funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit. Mandati i ZMNV-së është përfaqësimi i interesave të viktimateve në sistemin e drejtësisë në Kosovë.

ZMNV-ja gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023 ka trajtuar gjithsejtë 1,413 raste. Nga rastet në punë, kanë dominuar rastet e dhunës në familje me gjithsejtë 1,285 raste, dhunim 29 raste, sulm seksual 29 raste si dhe trafikim 14 raste. Rastet tjera janë keqpërdorim seksual nën moshën 16 vjeçare 17 raste, keqpërdorim seksual 2 rast, grabitje 1 raste, kanosje 3 rast, vrasje 3 raste, vrasje në tentativë 4 raste, bashkësi jashtëmartesore nën moshën 16 vjeç 17 raste, keqtrajtim i fëmijëve 3 raste, persona të humbur 1 raste, ngacmim 8 raste dhe 2 raste tjera.

Në kuadër të ZMNV-së funksionon edhe Operatori i Linjës Ndihmëse, që punon me operatorë, të cilët janë të angazhuar 24 orë dhe me një numër publik dhe pa pagesë, për t'iu mundësuar viktimateve dhe publikut një mekanizëm konfidencial për raportimin e veprave të ndryshme penale të abuzimit, për informimin e viktimateve dhe personave të tjera lidhur me të drejtat e tyre, sigurimin e informatave të nevojshme për shërbimet ekzistuese dhe numrat ekzistues. Në Linjën Ndihmëse janë pranuar gjithsejtë **150 thirrje**.

## 10. Njësia Ndërlidhëse për Përgjimet

Bazuar në Ligjin (Nr. 05/L-030) për përgjimin e komunikimeve elektronike, Njësia Ndërlidhëse bën aktivizimin ose ndalimin e përgjimit të pajisjeve fundore pas urdhrit të ligjshëm për përgjime të lëshuara nga gjykatat kompetente nën administrimin dhe kontrollin e Kryeprokurorit të Shtetit.

Funksioni i Njësisë Ndërlidhëse është përcaktuar me Rregulloren nr. 01/2016, ku është pasqyruar procedura e procesit të përgjimit ligjor, të drejtat dhe obligimet e zyrtarëve të autorizuar për zbatimin e procedurës së përgjimit duke u mbështetur në standarde të larta profesionale dhe zbatimin me sukses të masave të fshehta të përgjimit.

Për këtë, Kryeprokurori i Shtetit ka autorizuar prokurorin për administrimin dhe kontrollin e njësisë ndërlidhëse dhe stafin mbështetës, të cilët janë trajnuar në mënyrë profesionale për menaxhimin teknik të pajisjeve.

Njësia Ndërlidhëse në bashkëpunim me operatorët e komunikimeve elektronike: IPKO dhe PTK Vala ka vendosur dhe funksionalizuar terminalin menaxhues dhe pajisje të tjera në zyrat e kësaj njësie, të cilat janë të nevojshme për kryerjen e detyrave të përcaktuara me ligj.